

L I G J

PËR BANKËN POPULLORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT (TEKST I KONSOLIDUR JOZYRTAR)¹

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lënda e rregullimit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen organizimi dhe puna e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, detyrat dhe autorizimet e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga dita e aderimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Unionin Evropian dhe detyrat dhe autorizimet e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut pas aplikimit të euros si njësi monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Rrethi juridik

Neni 2

- (1) Ky ligj ka përparësi para ligjeve tjera.
- (2) Gjatë zbatimit të këtij ligji, çdo nocion i cili nuk është përkufizuar me këtë ligj, e ka kuptimin që është përkufizuar me ligj tjetër.
- (3) Nëse me këtë ligj ndonjë çështje lidhur me organizimin dhe punën e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme Banka Popullore) nuk është rregulluar, në atë rast zbatohen dispozitat e ligjit tjetër në të cilin është rregulluar ajo çështje.
- (4) Dispozitat e këtij ligj nuk mund të ndryshohen, plotësohen ose shfuqizohen tërësisht ose pjesërisht me dispozita nga ligji tjetër².

¹ Ky tekst të konsoliduar jozyrtar i Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë është i përbërë nga Ligji i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/10), Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.123/12), Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr 43/14), Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.153/15) dhe Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 6/16, 83/13 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.110/21 dhe 74/24) dhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 121/24) dhe („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.16/25“)

² Paragrafet e hijezuara janë shfuqizuar me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut të publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.121/24.

Statusi juridik

Neni 3

- (1) Banka Popullore është bankë qendrore e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (2) Banka Popullore është person juridik me pavarësi administrative, financiare dhe menaxhuese.
- (3) Banka Popullore ka autorizime për arritjen e qëllimeve dhe për kryerjen e detyrave të përcaktuara me këtë ligj.

Aftësia juridike

Neni 4

Banka Popullore si person juridik ka aftësi juridike që të veprojë në qarkullimin juridik, kryesisht kur:

- 1) lidh marrëveshje;
- 2) ngrit procedura juridike dhe është lëndë e të njejtave dhe
- 3) fiton, menaxhon, ruan dhe disponon me pronen e vet të tundshme dhe të patundshme.

Pavarësia

Neni 5

- (1) Banka Popullore është e pavarur gjatë arritjes së qëllimeve dhe detyrave dhe përgjegjesëni kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.
- (2) Banka Popullore, anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore dhe të punësuarit në Bankën Popullore nuk guxojnë të pranojnë dhe të kërkojnë instruksione nga organet e pushtetit shtetëror, organet e komunave, organet e qytetit të Shkupit dhe nga cilët do persona tjerë fizik edhe/ose juridikë.
- (3) Vendimet e Këshillit të Bankës Popullore nuk guxojnë të miratohen, shfuqizohen, abrogohen ose ndryshohen nga organet dhe personat nga paragrafi (2) i këtij neni.
- (4) Pavarësia e Bankës Popullore respektohet në çdo kohë dhe asnjëri nga organet dhe/ose personat nga paragrafi (2) i këtij neni, nuk guxojnë të ndikojnë të anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore dhe të të punësuarit në Bankën Popullore gjatë kryerjes së funksioneve të tyre, përkatësisht punëve, e as në aktivitetet e Bankës Popullore.

Qëllime

Neni 6

- (1) Qëllimi kryesor i Bankës Popullore është arritja dhe mbajtja e stabilitetit të çmimeve.
- (2) Qëllim tjetër i Bankës Popullore, që varet nga qëllimi kryesor, është të kontribuojë në arritjen dhe mirëmbajtjen e stabilitetit financiar.

- (3) Banka Popullore e përkrah politikën e përgjithshme ekonomike, pa u rrezikuar realizimi i qëllimit të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni dhe në pajtim me parimin e ekonomisë së hapur të tregut me konkurrencë të lirë.

Detyra

Neni 7

Për realizimin e qëllimeve nga neni 6 i këtij ligji, Banka Popullore i kryen detyrat në vijim:

- 1) e përcakton dhe e zbaton politikën monetare;
- 2) merr pjesë në përcaktimin e regjimit të kursit devizor;
- 3) e përcakton dhe e zbaton politikën e kursit devizor;
- 4) i ruan dhe menaxhon me rezervat devizore;
- 5) lëshon dhe menaxhon me kartëmonedha dhe monedha të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 6) zbaton hulumtime në fusha që janë të rëndësishme për arritjen e qëllimeve të Bankës Popullore;
- 7) grumbullon, përgatit dhe publikon të dhëna statistikore për kryerjen e detyrave në përputhje me ligjin;
- 8) vendos, zhvillon, rregullon dhe e mbikëqyr stabilitetin, sigurinë dhe efikasitetin e sistemeve të pagesave në përputhje me këtë ligj ose ligj tjetër;
- 9) rregullon, lëshon dhe revokon leje, lëshon dhe tërheq pëlqime dhe kryen supervizion mbi bankat, kursimoret dhe institucionet e tjera financiare në përputhje me këtë ligj ose ligj tjetër;
9-a) rregullon, lëshon dhe revokon leje, lëshon dhe tërheq pëlqime për institucione të pagesave, institucioneve të parasë elektronike dhe operatorëve të sistemit të pagesave dhe i mbikëqyr ofruesit e shërbimeve të pagesave, emetuesit e parasë elektronike dhe operatorët e sistemeve të pagesave, në përputhje me këtë ligj apo me ligj tjetër;
- 10) mbikëqyr zbatimin e rregulloreve me të cilat rregullohet puna devizore, puna e këmbimit, sistemet e parandalimit të larjes së parave dhe mbrojtjen e konsumatorëve, në përputhje me këtë ligj ose ligj tjetër;
- 10-a) zbaton politikë makroprudente dhe ndërmerr masa makroprudente ndaj bankave, kursimoreve dhe institucioneve të tjera financiare të cilave u lëshon leje dhe kryen aktivitete të tjera me qëllim të mirëmbajtjes së stabilitetit financiar, në përputhje me këtë ligj ose ligj tjetër;
- 10-b) kryen aktivitete për ndërhyrje të jashtëzakonshme mbi bankat, në përputhje me këtë ligj ose ligj tjetër;
- 11) kryen punë të agjentit fiskal të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 12) merr pjesë në institucionet dhe organizatat ndërkombëtare lidhur me çështjet që janë në kompetencë të saj;
- 13) organizon tregtim dhe barazim të letrave me vlerë në tregje, nëpërmjet sportelit dhe 14) kryen aktivitete tjera lidhur me kryerjen e detyrave të saj në pajtim me këtë ligj dhe ligj tjetër

Interesi publik

Neni 8

Stabiliteti i sistemit bankar, stabiliteti financiar dhe masat që ndërmerren për arritjen dhe mirëmbajtjen e tyre janë me interes publik.

Parimet për menaxhim të mirë

Neni 9

- (1) Banka Popullore i aplikon autorizimet që i ka në pajtim me parimet për menaxhim të mirë. Banka Popullore nuk i aplikon autorizimet për realizimin e qëllimeve për të cilat nuk i është dhënë autorizim, ose më tepër nga ajo që është e nevojshme që ta arrijë qëllimin për të cilin i është dhënë autorizimi.
- (2) Vendimet e Bankës Popullore janë të paanshme dhe bazohen në parakushte objektive dhe bazë të arsyeshme dhe zbatohen në mënyrë të drejtë, jodiskriminuese dhe të matur.

Selia dhe vula

Neni 10

- (1) Selia e Bankës Popullore është në Shkup.
- (2) Banka Popullore ka vulë në të cilën qëndron emri i Bankës Popullore i shkruar në gjuhën maqedonase me alfabet cirilik dhe stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Procedura administrative

Neni 11

- (1) Gjatë procedurës për miratimin e akteve të veçanta administrative për të cilat sipas këtij ligji dhe ligji tjetër vendos guvernatori ose Këshilli Ekzekutiv, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, nëse nuk është e rregulluar ndryshe me këtë ligj ose me ligj tjetër.
- (2) Kundër akteve administrative individuale nga paragrafi (1) i këtij neni nuk lejohet ankesë dhe mund të iniciohet kontest administrativ, përveç nëse me këtë ligj apo me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.
- (3) Dispozitat nga paragrafi (2) i këtij neni nuk kanë të bëjnë me aktet e miratuaranga guvernatori i Bankës Popullore në procedurat për furnizime publike.

II. KAPITALI, REZERVADHE FITIMI

Kapitali

Neni 12

- (1) Kapitali i Bankës Popullore në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji është 1 289 789 232 denarë.
- (2) Kapitali i Bankës Popullore është në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe i njëjti nuk mund të bartet ose të jetë lëndë e çfarë do ngarkese.
- (3) Kapitali i Bankës Popullore mund të rritet me vendim të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Bankës Popullore.
- (4) Kapitali i Bankës Popullore nuk guxon të zvogëlohet.

Rezervat

Neni 13

- (1) Banka Popullore formon rezerva të përgjithshme dhe të revalorizuara.
- (2) Rezerva e përgjithshme përdoret për mbulimin e humbjeve të Bankës Popullore.
- (3) Rezervat e revalorizuara formohen nga të ardhurat e parealizuar nga ndryshimet e kursit dhe çmimeve dhe përdoren për mbulimin e shpenzimeve të parealizuar nga ndryshimet e kursit dhe çmimeve, me ç'rast vlera e përgjithshme e rezervave të revalorizuara nuk mund të jetë më e ulët se zero.
- (4) Fshihet.

Rezultati financiar, fitimi i shpërndarjes dhe humbja e mbulimit

Neni 14

- (1) Rezultati financiar i Bankës Popullore përcaktohet në përputhje me Standardet ndërkombëtare për raportim financiar.
- (2) Rezultati financiar nga paragrafi 1 i këtij neni, i përshtatur për të ardhurat e parealizuar neto ose shpenzimet nga ndryshimet e kursit dhe çmimeve, të cilat veçohen ose mbulohen nga rezervat e revalorizuara dhe i përshtatur për të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara për të cilat kanë qenë të veçuara rezerva të revalorizuara, përfaqëson fitim për shpërndarje ose humbje për mbulimin për vitin financiar.

Shpërndarja e fitimit dhe mbulimi i humbjes

Neni 15

- (1) Në afat prej katër muajsh pas përfundimit të vitit financiar, Këshilli i Bankës Popullore e ndan rezultatin financiar për shpërndarje në këte mënyrë:
 - 1) 30% në rezervën e përgjithshme deri në arritjen e nivelit të kapitalit bazë nga neni 12, paragrafi (1) i këtij ligji, gjegjësisht 15% me arritjen e nivelit të kapitalit bazë nga neni 12, paragrafi (1) i këtij ligji, dhe
 - 2) pjesa e mbetur në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (2) Shpërndarja e të hyrave të Bankës Popullore mund të bëhet vetëm në mënyrën e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni.
- (3) Këshilli i Bankës Popullore në afat prej katër muajsh pas përfundimit të vitit financiar do të marrë vendim për mbulimin e humbjes për vitin financiar nga neni 14, paragrafi (2) i këtij ligji, i cili mbulohet nga rezerva e përgjithshme.
- (4) Nëse humbja është më e madhe se niveli i rezervës së përgjithshme, shuma mbi nivelin mbulohet nga fitimi në vitet në vijim, me çka së pari do të përdoret për mbulimin e humbjeve nga vitet e kaluara deri sa të mbulohen plotësisht dhe më pas shpërndahen në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni.

Mbulimi i deficitit në kapital

Neni 16

- (1) Nëse kapitali i përgjithshëm i Bankës Popullore i zvogëluar për humbjen e akumuluarët mbuluar nga viti aktual dhe paraprak është më i vogël se kapitali nga neni 12 i këtij ligji, shuma e nevojshme për arritjen e kapitalit sigurohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (2) Kapitali i përgjithshëm i Bankës Popullore nga paragrafi (1) i këtij neni paraqet përmbledhje të kapitalit nga neni 12 i këtij ligji, rezervë të përgjithshme dhe rezerva revalorizuese të nenit 13 të këtij ligji.
- (3) Këshilli i Bankës Popullore në afat prej 30 ditëve kalendarike nga miratimi i raporteve financiare vjetore të rishikuara të Bankës Popullore, i parashtron kërkesë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me arsyetim nga paragrafi (1) i këtij neni të nevojshëm për arritjen e kapitalit nga neni 12 i këtij ligji.
- (4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në afat jo më të gjatë se 60 ditë kalendarike nga pranimi i kërkesës nga paragrafi (3) i këtij neni, ia transferon Bankës Popullore shumën e nevojshme të mjeteve nga paragrafi (1) i këtij neni, edhe atë në para ose në letra debitore bartëse me vlerë me afat të caktuar të maturimit, të cilat janë emetuar sipas shkalles së kamatës të tregut që dominojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.”.

Hapja e llogarive

Neni 17

- (1) Për realizimin e aktiviteteve, Banka Popullore mund të hapë dhe mbaje llogari, duke i përfshirë edhe llogaritë për letra me vlerë:
 - 1) bankat, kursimoret, institucionet pagesore, institucionet e parasë elektronike, operatorët e sistemeve të pagesave, operatorët e sistemeve të përcaktimit dhe/ose barazimit në përputhje me ligjin që i rregullon instrumentet financiare, shtëpitë brokere/shoqëritë e investimeve, organet e pushtetit shtetëror dhe ndërmarrjet publike të themeluara nga shteti dhe
 - 2) të bankave të huaja, bankave qendrore të huaja, operatorëve të huaj të sistemeve të pagesave, institucioneve ndërkombëtare financiare, e ku është e përshtatshme për qeveritë e vendeve dhe organizatave tjera ndërkombëtare.
- (2) Banka Popullore nuk guxon të hapë llogari për persona fizikë dhe juridikë, përveç për ato nga paragrafi (1) i këtij neni.
- (3) Banka Popullore mund të hapë llogari te depozitarët dhe te bankat e huaja qendrore, bankat e huaja dhe institucionet financiare ndërkombëtare.
- (4) Këshilli i Bankës Popullore i përcakton kushtet e përgjithshme për hapjen e llogarive nga paragrafi (1) i këtij neni.

Shërbime rojtare të pronës

Neni 18

- (1) Banka Popullore mund të sigurojë shërbime rojtare të pronës të institucioneve financiare, duke i përfshirë edhe fondet pensionale në pajtim me ligjin dhe për këtë arkëton kompensim që është përkatës me shpenzimet e përcaktuara me ligj.
- (2) Këshilli i Bankës Popullore i përcakton kushtet në të cilat i siguron shërbimet rojtarë të pronës.

III. OPERACIONET MONETARE DHE TË TJERA

Operacionet e tregut të hapur dhe punët kreditore

Neni 19

(1) Për arritjen e qëllimeve dhe kryerjen e detyrave me këtë ligj, Banka Popullore mund t'i realizojë operacionet në vijim:

1) të punojë në tregjet financiare me emetimin e letrave me vlerë për qëllime monetare, blerjen dhe shitjen e bazës definitive (mentale dhe me afat) ose me marrëveshje repo dhe me dhënie ose marrjen e hua të kërkesave dhe instrumenteve të tregut, si dhe metaleve fisnike dhe 2) të kryejë punë kreditore me bankat, filiale të bankave të huaja dhe kursimoret që veprojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke dhënë kredi në bazë të sigurisë përkatëse.

(2) Këshilli i Bankës Popullore i përcakton kushte të përgjithshme dhe rregullat për realizimin e operacioneve dhe punëve kreditore nga paragrafi (1) i këtij neni.

Rezerva e detyrueshme

Neni 20

(1) Për realizimin e qëllimeve të politikës monetare, Banka Popullore mund t'u përcaktojë detyrim bankave, filialeve të bankave të huaja dhe kursimoreve që të mbajnë rezerva të detyrueshme në llogari në Bankën Popullore. Rezerva e detyrueshme është e njëjtë sipas kategorive të detyrimeve në nivel të bankave, kursimoreve dhe filialeve të bankave të huaja, veç e veç. Banka Popullore mund të paguajë kompensim të rezervës së detyrueshme.

(2) Këshilli i Bankës Popullore i përcakton kushtet, bazën dhe përqindjen për llogaritjen e rezervës së detyrueshme, si dhe mënyrën dhe afatet për ndarjen dhe mbajtjen e rezervës së detyrueshme.

(3) Në rast të mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni, Banka Popullore mund të arkëtojë kamatë ndëshkuese dhe të ndërmarrë masa tjera të parapara me ligj.

Instrumente tjera të politikës monetare

Neni 21

Këshilli i Bankës Popullore me dy të tretën e shumicës nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, mund të vendosë për përdorimin e instrumenteve tjera të politikës monetare për të cilat konsideron se janë të përshtatshme për realizimin e qëllimeve nga neni 6 i këtij ligji.

IV. REGJIMI I KURSIT DEVIZOR DHE REZERVAT DEVIZORE

Mbështetje likuiditeti në rrethana ekskluzive

Neni 22

- (1) Banka Popullore mund të sigurojë mbështetje likuiditeti në rrethana ekskluzive për një bankë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për të përmirësuar likuiditetin e bankës me qëllim të mirëmbajtjes së stabilitetit të sistemit financiar. Mbështetja e likuiditetit, si rregull, miratohet në denarë dhe, me përjashtim, në valutë të huaj.
- (2) Banka Popullore mund të miratojë mbështetje likuiditeti në rrethana ekskluzive vetëm nëse:
 - 1) sipas mendimit të Bankës Popullore, banka është solvende dhe e qëndrueshme;
 - 2) banka duhet të përmirësojë likuiditetin e saj; dhe 3) banka ka siguruar sigurinë e duhur.
- (3) Mbështetja e likuiditetit në rrethana ekskluzive është e përkohshme dhe miratohet në bazë afatshkurtër, me normë interesi më të lartë se norma më e lartë e interesit të instrumenteve monetare të Bankës Popullore.
- (4) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, vetëm në bazë të garancisë së siguruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Banka Popullore mund t'i sigurojë mbështetje likuiditeti në rrethana ekskluzive bankës që nuk ka garanci adekuate ose një bankë solvenca e së cilës nuk mund të konfirmohet në kohë ose në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi bankën.
- (5) Kur parashtrohet kërkesë për mbështetje të likuiditetit në rrethana ekskluzive, banka duhet të dorëzojë edhe një plan veprimi përkatës duke i cekur masat që do t'i ndërmarrë banka.
- (6) Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore vendos për miratimin e mbështetjes së likuiditetit në rrethana ekskluzive për bankën.
- (7) Këshilli i Bankës Popullore i përcakton kushtet dhe mënyrën e miratimit të mbështetjes së likuiditetit në rrethana ekskluzive, llojet e instrumenteve të sigurimit dhe aktivitetet e Bankës Popullore për menaxhimin e rreziqeve të mbështetjes së miratuar për likuiditet.
- (8) Nëse Banka Popullore konstaton se banka nuk është në gjendje të zbatojë planin e miratuar të veprimit, siç është cekur në paragrafin 5 të këtij neni, Banka Popullore do të marrë masa adekuate në përputhje me ligjin.

Regjimi i kursit devizor

Neni 23

Regjimi i kursit devizor kontraktohet bashkërisht ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Popullore, pa u rrezikuar qëllimi themelor për arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të çmimeve.

Përbërja e portofolit të rezervave devizore

Neni 24

- (1) Banka Popullore menaxhon me rezervat devizore në përputhje me praktikën më të reja ndërkombëtare dhe qëllimin kryesor – arritjen dhe mirëmbajtjen e stabilitetit të çmimeve, duke i respektuar parimet e sigurisë, likuiditetit, profitit.
- (2) Banka Popullore në portofolin e saj të rezervave devizore mund të mbajë të gjitha ose disa nga këto lloje të mjeteve:

- 1) arin të cilin e mban Banka Popullore ose mbahet për llogari të Bankës Popullore, duke përfshirë kërkesat e bazuara në arin;
 - 2) kartëmonedhat dhe monedhat të denominuara në valuta të lira konvertibile të huaja të cilat i mban, ose mbahen për llogari të Bankës Popullore;
 - 3) kërkesat dhe depozitat ndërbankare të pagueshme me kërkesë ose në afat të shkurtër, të denominuara në valutë të lirë konvertibile të huaj dhe të cilat mbahen në llogari të Bankës Popullore, te bankat e huaja qendrore, institucionet e huaja financiare ose institucionet financiare ndërkombëtare;
 - 4) letrat debitore me vlerë me të cilat mund të tregtohet në tregjet ndërkombëtare financiare, të denominuara në valuta të lira konvertibile të huaja;
 - 5) pjesë në fondet investuese që janë të regjistruara jashtë vendit;
 - 6) të drejta speciale të tërheqjes që mbahen në llogarinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe
 - 7) pozicionin rezervë të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Fondin Monetar Ndërkombëtar.
- (3) Banka Popullore, në funksion të menaxhimit me rezervat devizore, mund të kryejë transaksione, si dhe të krijojë kërkesa dhe detyrime në bazë të operacioneve me instrumentet financiare nga paragrafi 2 i këtij neni në tregjet financiare ndërkombëtare.

V. KARTEMONEDHAT DHE MONEDHAT

Emetimi i kartëmonedhave dhe monedhave

Neni 25

- (1) Banka Popullore ka të drejtë ekskluzive të emetojë kartëmonedha dhe monedha.
- (2) Vetëm kartëmonedhat dhe monedhat të emetuara nga Banka Popullore, të cilat nuk janë të tërhequra nga qarkullimi, janë mjet ligjor për pagesë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- (3) Banka Popullore e përcakton vlerën nominale, madhësinë, peshën, dizajnin, karakteristikat e sigurisë dhe të tjera të kartëmonedhave dhe monedhave të emetuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- (4) Banka Popullore është përgjegjëse për furnizimin me kartëmonedha dhe monedha të cilat janë mjet ligjor për pagesë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- (5) Keshilli i Bankës Popullore i përcakton kushtet dhe mënyrën e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha
- (6) Shuma e përgjithshme e kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim të emetuara nga Banka Popullore në raportet e saj financiare evidentohen si obligim. Obligimi i tillë nuk i përfshinë kartëmonedhat dhe monedhat nga teprica e rezervave të kartëmonedhave dhe monedhave të cilat ruhen prej anash ose për llogari të Bankës Popullore.
- (7) Banka Popullore e përcakton apoenin me të ulët në qarkullim me të cilin rrumbullakohet llogaritja e fundit në qarkullimin pagesor me para në dorë dhe pa para në dorë edhe në librat afariste.

Kartëmonedhat dhe monedhat e dëmtuara

Neni 26

- (1) Banka Popullore i tërheq, zëvendëson dhe i shkatërron kartëmonedhat dhe monedhate dëmtuara.
- (2) Banka Popullore mund të refuzojë të zëvendësojë kartëmonedha dhe monedha nëse dizajni i tyre është i dëmtuar, me formë të ndryshuar ose i shpuar, ose nëse me tëper se 40% nga

sipërfaqja e tyre mungon. Këto kartëmonedha dhe monedha tërhiqen ose shkatërrohen pa kompensim për pronarin, përveç nëse ekziston dëshmi se pjesët që mungojnë janë të shkatërruara tërësisht, me ç'rast Banka Popullore lejon kompensim të plotë ose të pjesshëm.

(3) Banka Popullore nuk jep kompensim për kartëmonedhat dhe monedhat të cilat janë të humbura, të vjedhura ose të shkatërruara tërësisht.

(4) Banka Popullore mund të konfiskojë pa kompensim kartëmonedha dhe monedha të cilat janë të ndryshuara në pamjen e tyre të jashtme, kryesisht kartëmonedhat dhe monedhat në të cilat është shkruar, të cilat janë ngjyrosur, në të cilat ka vula ose vrima ose te cilat janë lyer me materie ngjitëse.

Neni 26-a

(1) Banka Popullore kryen mbikëqyrje mbi kushtet dhe mënyrën e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha sipas neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji.

(2) Këshilli i Bankës Popullore i përcakton kushtet dhe mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes së paragrafit (1) të këtij neni.

Tërheqja dhe zëvendësimi i kartëmonedhave dhe monedhave

Neni 27

(1) Banka Popullore mund të tërheq kartëmonedha dhe monedha me emetim falas ët kartëmonedhave dhe monedhave tjera në shume ekuivalente.

(2) Këshilli i Bankës Popullore miraton vendim për tërheqjen e kartëmonedhave dhe monedhave në të cilin theksohet periudha gjatë së cilës do të kryhet zëvendësimi, si dhe vendi dhe koha në të cilën kartëmonedhat dhe monedhat do të zëvendësohen.

(3) Këshilli i Bankës Popullore e cakton datën në të cilën kartëmonedhat dhe monedhat pushojnë të jenë mjet ligjor për pagesë.

Teprica e kartëmonedhave dhe monedhave dhe plani për emetim

Neni 28

Banka Popullore menaxhon me tepricë të rezervave të kartëmonedhave dhe monedhave, bën plane për emetim dhe siguron furnizim të rregullt me kartëmonedha dhe monedha me qëllim që t'i sigurojë nevojat e Republikës së Maqedonisë së Veriut për kartëmonedha dhe monedha.

Kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara

Neni 29

(1) Kartëmonedhat dhe monedhat e pranuar nga institucionet financiare, të denominuara në mjet ligjor për pagesë në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në vend të huaj për të cilat ekziston mëdyshje se janë të falsifikuara, duhet të tërhiqen në pajtim me procedurën e përcaktuar nga Këshilli i Bankës Popullore.

(2) Vetëm Banka Popullore është e autorizuar që të japë mendim profesional për autenticitetin e kartëmonedhave dhe monedhave të denominuara në denarë ose në valutë të huaj.

(3) Banka Popullore i konfiskon kartëmonedhat të cilat i janë prezantuar, e për të cilat ekziston mëdyshje se janë të falsifikuara. Për kartëmonedhat e konfiskuara Banka Popullore dërgon njoftim me shkrim në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i cili përmban identifikim të kartëmonedhave, prurësin e tyre dhe shkakun për mëdyshjen nga ana e Bankës Popullore.

Reproduksioni i kartëmonedhave dhe monedhave

Neni 30

(1) Për çdo reproduksion të kartëmonedhave dhe monedhave të cilat janë mjet ligjor për pagesë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe krijim të lëndëve të cilat sipas dizajnit të vet imitojnë kartëmonedha dhe monedha të tilla është e nevojshme leje paraprake me shkrim nga Banka Popullore.

(2) Këshilli i Bankës Popullore e përcakton mënyrën dhe procedurën me të cilat lejohet publikimi i fotografive të njësisë monetare.

VI. SISTEMET PAGESORE, SUPERVIZIONI DHE MBIKËQYRJA, STATISTIKA DHE DETYRA TJERA NGA SFERA E SISTEMIT FINANICAR

1. Sistemet e pagesave

Neni 31

(1) Banka Popullore krijon kushte për punë stabile, të sigurt dhe efikase të sistemeve të pagesave në vend përmes themelimit, zhvillimit, rregullimit dhe mbikëqyrjes së tyre.

(2) Banka Popullore është e autorizuar të themelojë, menaxhojë, zhvillojë dhe të marrë pjesë në sistemet e pagesave dhe të veprojë si agjent për barazim të sistemeve dhe sistemeve të tjera të pagesave për përcaktimin dhe/ose barazimin në përputhje me ligjin me të cilin rregullohen instrumentet financiare.

Rregullimi dhe mbikëqyrja e operatorëve të sistemeve të pagesave

Neni 32

Banka Popullore është përgjegjëse për rregullimin, lëshimin dhe revokimin e lejeve dhe pëlqimeve dhe mbikëqyrje, duke përfshirë ndërmarrjen e masave dhe inicimin e procedurave për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse ndaj operatorëve të sistemeve të pagesave, në përputhje me këtë ligj apo ligj tjetër.

Aktivitetet e lidhura me sistemet pagesore

Neni 33

Banka Popullore ndërmer aktivitete për:

- 1) integrimin e sistemit për pagesë, sistemit për barazim dhe sistemeve tjera në pajtim me Ligjin për qarkullim pagesor;
- 2) zhvillimin e metodave dhe teknologjive të reja për pagesë dhe barazim dhe
- 3) Dizajnimin dhe modifikimin periodik të planit për zhvillimin e sistemit pagesor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2. Supervizioni dhe mbikëqyrja

Supervizioni

Neni 34

- (1) Banka Popullore është përgjegjëse për supervizionin e bankave, kursimoreve dhe institucioneve të tjera financiare, duke përfshirë ndërmarrjen e masave dhe iniciimin e procedurave për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse, në përputhje me këtë ligj ose me ligj tjetër.
- (2) Gjatë kryerjes së detyrave nga paragrafi (1) i këtij neni, Banka Popullore mund të bashkëpunojë dhe shkëmbejë të dhëna dhe informacione me organe dhe autoritete të supervizionit vendor ose të huaja, si dhe me organe kompetente për ndërhyrje të jashtëzakonshme mbi bankat nga jashtë, me kushtet dhe në mënyrën e përcaktuar me ligj.
- (3) Banka Popullore mund të lejojë supervizionin në terren në degën e bankës së huaj dhe filialit të bankës së huaj në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga organet e supervizionit të vendit amë të bankës së huaj. Ekzemplari nga raporti për supervizionin e kryer dërgohet në Bankën Popullore në afat prej dy muajsh pas përfundimit të kontrollit të supervizionit.
- (4) Për kryerjen e supervizionit ndaj bankave dhe kursimoreve, Banka Popullore prej tyre arkëton kompensim vjetor deri më 30 qershor në vitin aktual. Këshilli i Bankës Popullore, me vendim të veçantë e përcakton metodologjinë për përlllogaritjen e shumës së kompensimit vjetor për kryerjen e supervizionit ndaj bankave dhe kursimoreve, si dhe mënyrën e arkëtimit të tij, dhe gjatë kësaj merret parasysh madhësia e aktivitetit të tyre dhe e aktivitetit të ponderuar sipas rreziqeve.

Mbikëqyrja

Neni 34-a

- (1) Banka Popullore kryen mbikëqyrjen mbi punën e ofruesve të shërbimeve të pagesave, emetuesve të parasë elektronike dhe operatorëve të sistemeve të pagesave, duke përfshirë ndërmarrjen e masave dhe iniciimin e procedurave për shqiptimin e sanksioneve për kundërvajtje, në përputhje me këtë ligj ose me ligj tjetër.
- (2) Gjatë kryerjes së detyrave nga paragrafi (1) i këtij neni, Banka Popullore mund të bashkëpunojë dhe shkëmbejë të dhëna dhe informacione me organet dhe autoritetet kompetente vendore dhe të huaja, të cilat mund të përdoren vetëm për qëllime të mbikëqyrjes dhe të njëjtat do të konsiderohen si konfidenciale për palën që i pranon.

3. Statistika

Të dhënat statistikore dhe informatat

Neni 35

Për kryerjen e qëllimeve dhe detyrave, Banka Popullore:

- 1) grumbullon, përpunon, analizon, vecon dhe publikonte dhëna statistikore dhe informata që janë relevante për kryerjen e detyrave të saj;
- 2) i cakton personat fizikë dhe juridik të cilët janë të obliguar që të dorëzojnë të dhëna statistikore dhe informata;
- 3) i përcakton të dhënat statistikore dhe informatat të cilat dërgohen në Bankën Popullore, si dhe zbatimin e rregullave për fshehtësi;
- 4) bashkëpunon me organete pushtetit shteteror, ndërmarrjet publike, institucionet publike dhe shoqëritë tregtare të themeluara nga shteti ose në të cilat shteti është pronar dominues gjatë grumbullimit, përpunimit dhe publikimit të informatave statistikore dhe informatave tjera relevante dhe
- 5) bashkëpunon me institucione financiare ndërkombëtare dhe institucione tjera lidhur me miratimin e standardeve ndërkombëtare për distribuimin e të dhënave me qëllim të arritjes së konsistencës dhe efikasitetit në grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave statistikore dhe informatave.

Dorëzimi i të dhënave statistikore dhe informatave

Neni 36

- (1) Subjektet nga neni 35 pika 2 të këtij ligji janë të obliguar që t'i dorëzojnë në Bankën Popullore të dhënat statistikore dhe informatat.
- (2) Menyrën e dërgimit, formën dhe afatet për dërgimin e të dhënave dhe informatave statistikore nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton Këshilli i Bankës Popullore.

Qasja në të dhënat statistikore dhe informatat

Neni 37

Banka Popullore siguron qasje nëpërmjet publikimit në faqen e saj të internetit ose në mënyre tjetër të:

- 1) të dhënave statistikore dhe informatave në pajtim me rregullat për fshehtësi dhe
- 2) metodologjive dhe koncepteve të cilat zbatohen gjatë grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave statistikore dhe informatave, të cilat do të mundësojnë verifikimin e të dhënave statistikore të përpiluara nga Banka Popullore.

4. Detyrat tjera nga sfera e sistemit financiar

Stabiliteti financiar

Neni 38

- (1) Banka Popullore e realizon qëllimin e saj për të kontribuar në arritjen dhe mirëmbajtjen e stabilitetit financiar përmes detyrave dhe aktiviteteve që i kryen në përputhje me këtë ligj apo me ligj tjetër.

(2) Për nevojat e paragrafit (1) të këtij neni, si dhe gjatë zbatimit të politikës makroprudenciale, Banka Popullore:

- 1) merr pjesë në punën e Komitetit të Stabilitetit Financiar dhe Nënkomitetit për monitorimin e rreziqeve sistematike dhe propozimin e masave makroprudenciale dhe Nënkomitetit për përgatitjen për menaxhimin me krizën financiare;
- 2) harton strategji makroprudenciale, si dhe ndryshimet dhe/ose plotësimet e saj dhe ia propozon për miratim Komitetit për Stabilitet Financiar;
- 3) i identifikon rreziqet që mund të prishin stabilitetin financiar, që përfshin monitorimin e rreziqeve sistematike në sistemin bankar dhe në segmente të tjera të sistemit financiar, monitorimin e lidhjes ndërmjet segmenteve individuale të sistemit financiar dhe paraqitjen e informacioneve në Nënkomitetin për monitorimin e rreziqeve sistematike dhe propozimin e masave makroprudenciale dhe
- 4) bashkëpunon dhe kërkon të dhëna dhe informacione nga institucionet financiare, organet kompetente, organet e pushtetit shtetëror, ndërmarrjet publike, institucionet publike dhe shoqëritë tregtare të themeluara nga shteti ose në të cilat shteti është pronar dominues dhe institucione të tjera, shoqëri, fonde, agjenci, shoqata.

(3) Të dhënat dhe informacionet nga paragrafi (2) pika 4) të këtij neni jepen pa kompensim.

(4) Në bazë të të dhënave dhe informacioneve të mbledhura nga paragrafi (2) pika 4) të këtij neni, Banka Popullore përgatit raport vjetor për stabilitetin financiar të cilin e publikojnë përputhje me nenin 62 paragrafi (4) të këtij ligji.

Ndërhyrja e jashtëzakonshme mbi bankat

Neni 38-a

(1) Banka Popullore është kompetente për zbatimin e aktiviteteve përgatitore për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën, fillimin e procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe zbatimin e instrumenteve dhe autorizimeve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën, në përputhje me këtë ligj ose me ligj tjetër.

(2) Gjatë kryerjes së aktiviteteve nga paragrafi (1) i këtij neni, Banka Popullore mund të bashkëpunojë dhe shkëmbejë të dhëna dhe informacione me Ministrinë e Financave, Fondin për Sigurimin e Depozitave/Agjencinë për Mbrojtjen e Depozitave dhe organet dhe institucionet tjera kompetente vendore, si dhe me organet kompetente për supervizion dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankat nga jashtë ose për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi institucionet tjera financiare në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose nga vende të tjera, në kushtet dhe në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Regjistri kreditor

Neni 39

(1) Banka Popullore vendos dhe menaxhon Regjistër kreditor në formë elektronike në formë në të cilën vendosen të dhënat dhe informatat lidhur me nënshtrimin kreditor dhe rrezikun e tyre kreditor të bankave dhe të kursimoreve të themeluara në Republikën e Maqedonisë së Veriut ndaj personave juridik dhe fizik.

(2) Bankat dhe kursimoret janë të detyruara në Bankën Popullore të dorëzojnë të dhëna dhe informata nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Përmbytjen e të dhënave dhe informacioneve nga paragrafi (1) i këtij neni, mënyrën dhe afatet e dorëzimit, mënyrën e korrigjimit të të dhënave të pasakta ose jo të plota, si dhe mënyrën dhe kushtet për përdorimin e këtyre të dhënave nga bankat dhe kursimoret dhe për qasje të

personave fizikë në të dhënat personale nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton Këshilli i Bankës Popullore.

(4) Banka Popullore në Regjistrin kreditor i përpunon këto kategori të të dhënave personale: emri dhe mbiemri, numri i amzes (NUAQ), kodi banues/jobanues, komuna e banimit, numri i partisë kreditore dhe të dhëna të tjera për nënshtrimin kreditor të personave fizikë.

(5) Në Regjistrin kreditor kryhet përpunimi i të dhënave personale nga paragrafi (4) i këtij neni për këto kategori të subjekteve: personat ndaj të cilëve është vendosur ekspozim kreditor dhe garantuesit.

(6) Kategoritë e subjekteve, të dhënat personale të të cilëve përpunohen nga paragrafi (5) i këtij neni, nuk mund të kërkojnë kufizim të përpunimit të të dhënave të tyre personale në Regjistrin kreditor, duke pasur parasysh qëllimet për të cilat përdoren të dhënat nga Regjistri kreditor, të cilat ndërlidhen me stabilitetin e sistemit bankar, që është një interes publik i përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji.

(7) Të dhënat dhe informatat e grumbulluara për nevojat e Regjistrit kreditor përdoren me qëllim të përmirësimit të cilësisë së kredive, për nevojat e mbikëqyrjes, të përcjelljes së rreziqeve për stabilitet financiar dhe për nevojat e statistikes së Bankës Popullore.

(8) Të dhënat personale të shënuara në Regjistrin kreditor përpunohen dhe ruhen në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

(9) Të dhënat personale që i përmban Regjistri kreditor ruhen dhjetë vjet nga dita e mbylljes së ekspozimit kreditor nga paragrafi (1) i këtij neni.

(10) Të dhënat personale që i përmban Regjistri kreditor u jepen për përdorim personave nga neni 74 të këtij ligji vetëm me kushtet dhe në mënyren e parashikuar nga neni 74 i këtij ligji dhe rregulloret që e rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale.

VII. MARRËDHENIET ME KUVENDIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, QEVERINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT DHE SUBJEKTET TJERA

Marrëdhëniet me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Neni 40

(1) Këshilli i Bankës Popullore dhe çdo anëtar i tij është përgjegjës para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të çmimit dhe për realizimin e detyrave të Bankës Popullore të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose me vetiniciativë, guvernatori i Bankës Popullore periodikisht mund t'i drejtohet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose komisioneve të tij, lidhur me çështjet nga politika monetare dhe sistemi financiar dhe gjendja e ekonomisë, me përjashtim të informacioneve specifike që kanë të bëjnë me subjektet që janë objekt i supervizionit.

(3) Gjatë fjalimit të guvernatorit para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut respektohen dispozitat e konfidencialitetit, të përcaktuara me nenin 74 të këtij ligji.

(4) Banka Popullore në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të dërgojë mendime për propozim-ligjet që janë të lidhura me qëllimet dhe detyrat e Bankës Popullore.

Bankari, këshilltari financiar, agjenti fiskal

Neni 41

- (1) Banka Popullore kryen punë bankare për nevojat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (2) Me kërkesë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Banka Popullore mund të kryejë punë të këshilltarit financiar të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (3) Banka Popullorene emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të pranojë hua të huaja, t'i menaxhojë dhe administrojë, si dhe t'i barazojë kërkesat dhe obligimet financiare të Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj vendit të huaj.
- (4) Banka Popullore në kushte të kontraktuara me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të kryejë punë të agjentit fiskal për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (5) Banka Popullore mund të pranojë depozita nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe organet tjera të administratës shtetërore. Si depozitar Banka Popullore pranon dhe paguan para nga llogaritë dhe jep shërbime tjera financiare lidhur me këtë aktivitetet.
- (6) Banka Popullore për depozitat nga paragrafi (5) i këtij neni, mund të paguajë kamatë në shkallë të cilat nuk mund të jenë më të larta se shkallët kamatore të tregut.
- (7) Banka Popullore kryen pagesa deri në lartësinë e mjeteve në disponim sipas urdhër pagesave lidhur me ato llogari.

Emetimi i monedhave jubilarë

Neni 42

Banka Popullore emeton monedha jubilarë në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me Ligjin për monedha jubilarë.

Emetimi i monedhave për qëllime koleksionimi

Neni 42-a

- (1) Banka Popullore mund të emetojë monedha për qëllime koleksionimi.
- (2) Këshilli i Bankës Popullore i përcakton mënyrën dhe procedurën për emetimin dhe formën dhe përmbajtjen e monedhave nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe disponimin me to.

Bashkëpunimi me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Neni 43

- (1) Banka Popullore bashkëpunon me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë realizimit të qëllimeve të saj të përcaktuara me këtë ligj.
- (2) Guvernatori dhe ministri i Financave mbajnë mbledhje të rregullta për politiken monetare dhe fiskal edhe informohen për çështje tjera me interes të përbashkët.

(3) Banka Popullore mund të japë mendim në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për çështje të cilat kanë të bëjnë me qëllimin kryesor dhe detyrat e Bankës Popullore.

(4) Banka Popullore dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të shkëmbejnë informata lidhur me kryerjen e detyrave të Bankës Popullore, me përjashtim të informatave specifike të cilat kanë të bëjnë me subjektet të cilat janë lënde e supervizionit.

(5) Me përjashtim të paragrafit 4 të këtij neni, Banka Popullore do ta njoftojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkaktimin e rrethanave të jashtëzakonshme në kuadër të sistemit financiar, në mënyrë që të sigurohet konfidencialiteti i të dhënave në përputhje me nenin 74 të këtij Ligji.

(6) Me kërkesë të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e me qëllim të informimit të saj, Banka Popullore siguronte dhëna për pranimin e mjeteve nga ana e Bankës Popullore nga cilat do qofshin burime.

(7) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut konsultohet me Banken Popullore gjatë përpilimit të rregullave të cilat kanë të bëjnë me çështjet lidhur me qëllimet, detyrat dhe kompetencat e Bankës Popullore të përcaktuara me këtë ligj ose ligj tjetër.

Ndalimi për kreditim

Neni 44

(1) Banka Popullore nuk i miraton, drejtpërdrejt ose tërthorazi, kredi Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ose ndonjë organi tjetër shtetëror, ndërmarrjeje publike, institucioni publik, shoqëri tregtare të themeluar nga shteti ose në të cilën është shteti pronar dominues, organ të komunave, komunë e Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

(2) Dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohen në bankat në pronësi shtetërore dhe subjektet tjera në pronësi shtetërore, që janë lëndë e supervizionit dhe të cilat kanë trajtim të njejtë, si dhe bankat private dhe subjektet tjera private që janë lëndë e supervizionit. (3) Banka Popullore mund të blejë letra shtetërore me vlerë vetëm në tregun sekondar.

Ndalimi i qasjes së privilegjuar

Neni 45

(1) Çdo masë e cila nuk është e bazuar në parimet bankare për kujdes dhe siguri dhe e cila Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, organit tjetër të pushtetit shtetëror, ndërmarrjeje publike, institucioneve publike, shoqërive tregtare të themeluara nga shteti ose në të cilat shteti është pronar dominues, organeve të komunave, komunavete qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit, u mundëson qasje të privilegjuar në institucionet financiare, është e ndaluar.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut i përcakton rastet në zbatimin e ndalimit nga paragrafi (1) i këtij neni.

VIII. MENAXHIMI DHE ORGANIZIMI

Organet e Bankës Popullore

Neni 46

- (1) Organet e Bankës Popullore janë Këshilli i Bankës Popullore dhe Këshilli Ekzekutiv.
- (2) Me Bankën Popullore menaxhon Këshilli i Bankës Popullore.
- (3) Këshilli Ekzekutiv vepron në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj ose me ligj tjetër.
- (4) Këshilli i Bankës Popullore përbëhet nga nëntë anëtarë, nga të cilët guvernatori dhe tre viceguvernatorë kanë statusin e anëtarëve ekzekutivë dhe pesë anëtarëve joekzekutivë.
- (5) Anëtarët joekzekutivë marrin pjesë në vendimmarrjen e Këshillit të Bankës Popullore.
- (6) Këshilli i Bankës Popullore është i obliguar për përkufizimin dhe formulimin e politikave dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, si dhe mbikëqyrjen e punës së Bankës Popullore.
- (7) Guvernatori i Bankës Popullore kryeson me Këshillin e Bankës Popullore dhe Këshillin Ekzekutiv, i cili ka funksionin kryesor ekzekutiv në Bankën Popullore dhe është i ngarkuar me punët e përditshme të saj.
- (8) Guvernatori një pjesë të kompetencave dhe detyrave të tij, të përcaktuara në nenin 48 paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji, ua bart tre viceguvernatorëve të Bankës Popullore.
- (9) Guvernatori dhe tre viceguvernatorët e përbëjnë Këshillin Ekzekutiv të Bankës Popullore.

Autorizimet dhe detyrat e Këshillit të Bankës Popullore

Neni 47

- (1) Këshilli i Bankës Popullore i ka autorizimet dhe detyrat në vijim:
 - 1) i përkufizon dhe i miraton politikat monetare dhe politikën e kursit devisor të Bankës Popullore;
 - 2) e përkufizon regjimin e kursit devisor në pajtim me nenin 23 të këtij ligji;
 - 3) i formulon dhe miraton politikat e Bankës Popullore lidhur me kryerjen e detyrave të saj dhe miraton rregulla interne për zbatimin e tyre;
 - 4) e miraton Planin e kontos për bankat në pajtim me ligjin;
 - 5) e shqyrton zbatimin e politikave dhe kryerjen e detyrave të Bankës Popullore;
 - 6) i miraton rregullat nënligjore në kompetencë të Bankës Popullore;
 - 6-a) e zbaton politikën makroprudenciale duke përcaktuar instrumentet makroprudenciale dhe mënyrën e zbatimit të tyre në përputhje me këtë ligj apo ligj tjetër;
 - 7) e miraton Statutin e Bankës Popullore;
 - 8) e miraton Kodeksin etik për anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore dhe për të punësuarit;
 - 9) i përcakton politikat e përgjithshme dhe rregullat interne lidhur me punën e Bankës Popullore;
 - 9-a) Fshihet.
 - 10) i përcakton rregullat interne për zbatimin e dispozitave lidhur me ekzistimin e konfliktit të interesave;
 - 10-a) e miraton Vendimin për përcaktimin e metodologjisë për përlogaritjen e lartësisë së kompensimit vjetor për kryerjen e supervizionit ndaj bankave dhe kursimoreve, si dhe mënyrën e arkëtimit të tij;
 - 11) e përcakton organizimin e Bankës Popullore, vendos për sistematizimin e detyrimeve të punës së njësive organizative, aktiviteteve dhe detyrave të tyre, klasifikimin e vendeve të punës, i përcakton kushtet e përgjithshme të punësimit, duke përfshirë rrogat dhe shtesat e rrogës, me propozimin e guvernatorit, në përputhje me ligjin;
 - 11-a) vendos për hapjen dhe lokacionin e filialeve, përfaqësive dhe pjesëve të tjera organizative;
 - 12) merr vendimin për publikimin e shpalljes interne për emërimin e revizorit kryesor të brendshëm dhe vendimin për zgjedhjen e revizorit kryesor të brendshëm;
 - 13) i përcakton detyrimet për raportim statistikor;

- 14) e miraton planin financiar vjetor të Bankes Popullore;
 - 14-a) e miraton Planin vjetor për investime të Bankës Popullore;
 - 14-b) e miraton Planin vjetor për prokurime publike të Bankës Popullore;
 - 15) i përcakton politikat e kontabilitetit të Bankës Popullore dhe i miraton raportet nga neni 62 i këtij ligji dhe raportet financiare të Bankës Popullore; 16) e zgjedh shoqërinë për revizion të Bankës Popullore;
 - 17) vendos për ngarkimin me borxh të Bankës Popullore dhe i përcakton kushtet e ngarkimit me borxh;
 - 18) i përcakton llojet e mjeteve nga neni 24 paragrafi (2) i këtij ligji të cilat i përbëjnë rezervat devizore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
 - 19) i përcakton llojet e mjeteve në të cilat Banka Popullore mund t'i investojë mjetet financiare;
 - 20) i përcakton denominimet dhe dizajnine kartemonedhave dhe monedhave, si dhe emetimin e tyre;
 - 20-a) krijon Komitetin e Revizionit dhe e përcakton mënyrën e punës së tij;
 - 21) formon një ose më shumë organe pune, këshillimore dhe organe të tjera dhe i përkufizon detyrat dhe aktivitetet e tyre;
 - 22) i vlerëson rreziqet dhe miraton plane për raste të paparashikueshme për punën rrjedhese dhe sigurinë e Bankës Popullore;
 - 23) vendos për emetimin e monedhave për qëllime koleksionimi;
 - 24) e miraton rregulloren për punë të Këshillit të Bankës Popullore dhe
 - 25) miraton akte dhe kryen pune të tjera të përcaktuara me këtë ligj ose ligj tjetër.
- (2) Gjatë kryerjes së autorizimeve dhe detyrave anëtare të Këshillit të Bankës Popullore veprojnë veçanërisht në interes të qëllimeve dhe detyrave të Bankës Popullore.

Autorizimet dhe detyrat e guvernatorit

Neni 48

- (1) Guvernatori i ka këto autorizime dhe detyra:
 - 1) e përfaqëson Bankën Popullore;
 - 2) është përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve të Këshillit të Bankës Popullore dhe për kontrollin e menaxhimit dhe punës së Bankës Popullore dhe
 - 3) kryen punë të tjera që me këtë ligj nuk janë të përcaktuara në kompetencë të Këshillit të Bankës Popullore dhe Këshillit Ekzekutiv.
- (2) Në kuadër të autorizimeve të tij, guvernatori mund t'i ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme ose adekuate gjatë menaxhimit dhe punës së Bankës Popullore, duke përfshirë blerje të shërbimeve dhe mallrave, obligimet kontraktuese në emër të Bankës Popullore dhe punësimin, si dhe zgjedhjen e agjenteve të Bankës Popullore.
- (3) Guvernatori mund të themelojë një ose më shumë organe pune, këshillimore dhe organe të tjera dhe i përkufizon detyrat dhe aktivitetet e tyre.
- (4) Në kuadër të rregullave të miratuara nga ana e Këshillit të Bankës Popullore, guvernatori mund t'ua bartë disa nga autorizimet ose detyrat e tij anëtarëve tjerë të Këshillit të Bankës Popullore ose personave me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta në Bankën Popullore.
- (5) Guvernatori rregullisht e njofton Këshillin e Bankës Popullore për punën e Bankës Popullore dhe zbatimin e politikave, për çështje lidhur me stabilitetin e sistemit bankar dhe për gjendjen e tregut të parave dhe tregjeve devizore, duke përfshirë të gjitha ngjarjet dhe gjendjet e tregut që kanë pasur ose pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në punën e Bankës Popullore, në zbatimin të politikave të saj, në sistemin financiar ose në tregun e parave dhe tregun devizor.

(6) Guvernatori paraprakisht e përcakton radhitjen sipas së cilës zëvendës guvernatorët do ta zëvendësojnë gjatë periudhes së mungesës së tij ose pengimit për realizimin e obligimeve.

Autorizimet dhe detyrat e Këshillit Ekzekutiv

Neni 48-a

(1) Këshilli Ekzekutiv i ka këto kompetenca dhe detyra:

- 1) zbaton politikën monetare dhe të kursit devizor, si dhe politikat tjera në përputhje me rregullat dhe vendimet e brendshme të Këshillit të Bankës Popullore;
- 2) ndërmerr masa makroprudenciale me qëllim të zbatimit të politikës makroprudenciale, në përputhje me këtë ligj apo me ligj tjetër;
- 3) vendos për lëshimin dhe revokimin e lejeve, dhënien dhe tërheqjen e pëlqimeve të bankave, kursimoreve, dhe institucioneve të tjera financiare dhe për dhënien dhe tërheqjen e pëlqimeve të aksionarëve me pjesëmarrje të kualifikuar në bankë, në përputhje me ligjin; 4) vendos për fillimin e procedurës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën dhe për zbatimin e instrumenteve dhe autorizimeve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën, në përputhje me ligjin; 5) ndërmerr masa ndaj bankës, kursimoreve dhe institucioneve të tjera financiare që janë objekt i supervizionit nga Banka Popullore, në përputhje me ligjin
- 6) vendos për lëshimin dhe revokimin e lejeve dhe dhënien dhe tërheqjen e pëlqimeve të institucioneve të pagesave, institucioneve të parasë elektronike dhe operatorëve të sistemeve të pagesave, në përputhje me ligjin;
- 7) ndërmerr masa ndaj institucioneve të pagesave, institucioneve të parasë elektronike dhe operatorëve të sistemeve të pagesave që janë objekt i mbikëqyrjes nga Banka Popullore, në përputhje me ligjin dhe
- 8) kryen punë të tjera në përputhje me këtë ligj se me ligj tjetër.

(2) Vendimet e Këshillit Ekzekutiv, me të cilat ndërmerren masa makroprudenciale në përputhje me paragrafin (1) pika 2) të këtij neni ndaj të gjitha bankave dhe/ose kursimoreve dhe/ose institucioneve të tjera financiare, publikohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Emërimi

Neni 49

- (1) Anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore emërohen me mandat prej shtatë vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.
- (2) Guvernatorin e emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Kryetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (3) viceguvernatorët i emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të guvernatorit.
- (4) Anëtarët joekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore i emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kriteret për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Bankës Popullore

Neni 50

- (1) Anëtar i Këshillit të Bankës Popullore mund të jetë personi, shtetasi Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili ka reputacion adekuat, së paku arsimim të lartë dhe eksperiencë adekuate profesionale ose akademike në fushën e ekonomisë, financave, veprimtarisë bankare ose të drejtësisë.
- (2) Anëtar i Këshillit të Bankës Popullore nuk mund të jetë personi:
 - 1) i dënuar për vepër penale me dënim me burg ose dënim me para; (është shfuqyruar me vendim të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, të shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", nr 64/2012).
 - 2) debitor në procedurë falimentuese ose likuiduese;
 - 3) të cilit i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe
 - 4) të cilit i është shqiptuar dënim dytësor ndalim për marrjen e lejes për themelim dhe punë të bankës ose institucionit tjetër financiar, marrje e lejes për punë në bankë ose institucion tjetër, ndalim për themelimin e personave të rinj juridikë dhe ndalim i përkohshëm ose i përhershëm për kryerjen e veprimtarisë nga sfera e financave dhe veprimtarisë bankare.
- (3) Guvernatori dhe viceguvernatori i Bankës Popullore janë të angazhuar profesionalisht në Bankën Popullore, nuk guxojnë të kenë angazhim tjetër të punës, pa marrë parasysh nëse për këtë marrin kompensim apo jo, përveç angazhimit si profesor universitar ose angazhimin në institucion shkencor hulumtues, ose angazhimin të përkohshëm në institucion financiar ndërkombëtar, nuk guxojnë të jenë pronarët e kapitalit në institucionin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe gjatë mandate tnuak guxojnë të jenë anëtarë të parties politike ose sindikates.
- (4) Anëtar joekzekutiv i Këshillit të Bankës Popullore nuk mund të jetë personi i cili është deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, anëtar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, i punësuar në organe shtetërore ose të pushtetit lokal, agjenci, fonde, ndërmarrje publike, institucione publike, shoqëri tregtare të themeluara nga shteti ose në të cilat shteti është pronar dominues, i punësuar në institucion financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pronari i kapitalit në institucionin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, anëtar i organit drejtues ose organit mbikqyrës në bankë, kursimore ose në shoqëri tregtare tjetër e cila mund të ketë konflikt interesash me Bankën Popullore, si dhe anëtar i organeve të partisë politike dhe organeve të sindikates.
- (5) Me përjashtim nga paragrafi (4) i këtij neni, anëtar joekzekutiv i Këshillit të Bankës Popullore mund të jete profesor universitar ose i punësuar në institucionin hulumtues-shkencor.
- (6) Anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore obligohen që menjëherë pas emërimit në funksion të harmonizohen me dispozitat nga paragrafi (4) i këtij neni.

Neni 50-a

- (1) Për emërim të viceguvernatorit dhe anëtarit joekzekutiv të Këshillit të Bankës Popullore publikohet shpallje publike në së paku tri gazeta ditore të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të cilat njëra nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.
- (2) Viceguvernatori dhe anëtar i joekzekutiv i Këshillit të Bankës Popullore, përveç kriterëve nga neni 50 të këtij ligji, duhet t'i plotësojë edhe kushtet në vijim:
 - 1) posedon njerën nga certifikatat vijuese të njohura ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,

- IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë;
- ILEC (ILEC) (Cambridge English:Legal) - së paku niveli B2 (B2),
- FCE(FCE) (Cambridge English:First) - të dhënë - BULATS (BULATS) - se paku 60 pike ose - APTIS (APTIS)- se paku niveli B2 (B2).

Pushimi i mandatit

Neni 51

(1) Mandati i anëtarit të Këshillit të Bankës Popullore i pushon:

- 1) me skadimin e mandatit;
 - 2) në rast të vdekjes;
 - 3) në rast të dorëheqjes; 4) në rast të humbjes së aftësisë afariste dhe 5) në rast të shkarkimit.
- (2) Në rastet nga paragrafi (1), pikat 2) dhe 4) të këtij neni, Këshilli i Bankës Popullore do ta njoftojë Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut menjëherë sapo të mësohet për shkaktimin e rasteve të tilla, ndërsa për rastet nga paragrafi (1) pika 1) të këtij neni, do ta njoftojë së paku 3 muaj para skadimit të mandatit.

Dorëheqja

Neni 52

- (1) Guvernatori, viceguvernatori dhe anëtarët joekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore mund të parashtrijë dorëheqje nga funksioni me njoftim paraprak me shkrim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në afat jo më të shkurtër se 3 muaj nga dita e parashtrimit të njoftimit me shkrim për dorëheqje, për çka do ta njoftojë Këshillin e Bankës Popullore paraprakisht.
- (2) Njoftimi në Këshillin e Bankës Popullore nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet në afat jo më të shkurtër se 30 ditë para dorëzimit të njoftimit me shkrim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në formë me shkrim.

Shkarkimi

Neni 53

- (1) Anëtari i Këshillit të Bankës Popullore shkarkohet nga funksioni para skadimit të mandatit, kur:
- 1) do të pushojë që t'i plotësojë disa nga kriteret për emërimin e anëtarit të Këshillit të Bankës Popullore të përcaktuara në nenin 50 të këtij ligji;
 - 2) kryen keqpërdorim ose lëshim serioz në kryerjen e detyrës zyrtare ose
 - 3) ka munguar pa arsye në tri seanca radhazi të Këshillit të Bankës Popullore ose ka munguar pa arsye në gjithsej pesë seanca gjatë një viti pa miratimin e Këshillit të Bankës Popullore.
- (2) Vendim për shkarkimin e anëtarit të Këshillit të Bankës Popullore miraton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut:

- 1) me rekomandim të Këshillit të Bankës Popullore, ose me rekomandim të Kryetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e pas konsultimit të Këshillit të Bankës Popullore, nëse vendimi ka të bëjë me guvernatorin;
- 2) me rekomandim të Këshillit të Bankës Popullore, ose me rekomandim të guvernatorit, e pas konsultimit të Këshillit të Bankës Popullore, nëse vendimi ka të bëjë me viceguvernatorin ose 3) me rekomandim të Këshillit të Bankës Popullore, ose me rekomandim të guvernatorit, e pas konsultimit të Këshillit të Bankës Popullore ose me rekomandim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e pas konsultimit të guvernatorit, nëse vendimi ka të bëjë me anëtarët joekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore.
- (3) Rekomandimet nga paragrafi (2) i këtij neni, Këshilli i Bankës Popullore i miraton me shumicë votash të të gjithë anëtarëve.
- (4) Nëse në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së rekomandimit nga paragrafi (3) i këtij neni, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk e shkarkon anëtarin e Këshillit të Bankës Popullore për plotësimin e kushteve nga paragrafi 1 i këtij neni, Këshilli i Bankës Popullore merr vendim me të cilin ai anëtar i Këshillit të Bankës Popullore nuk mund të marrë pjesë në seancat e Këshillit të Bankës Popullore deri në miratimin e vendimit përfundimtar për shkarkim nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (5) Anëtari i shkarkuar i Këshillit të Bankës Popullore ka të drejtë të parashtrojë padi në gjykatën kompetente në afat prej 15 ditësh kalendarike nga dita e miratimit të vendimit për shkarkim.

Funksionet pas përfundimit të mandatit

Neni 54

- (1) Anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore në periudhë prej një viti nga mbarimi i mandatit nuk mund angazhohen profesionalisht në bankë ose në institucion tjetër financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- (2) Anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore nga paragrafi (1) i këtij neni, kanë të drejtë për kompensim adekuat të përcaktuar nga ana e Këshillit të Bankës Popullore deri në punësimin e tyre, por më së shumti për periudhë prej një viti nga mbarimi i mandatit.
- (3) Dispozitat nga paragrafi (2) i këtij neni, nuk kanë të bëjnë me anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore të cilët janë shkarkuar në pajtim me nenin 53 paragrafi (1) të këtij ligji.

Plotësimi i vendit të zbrazët në Këshillin e Bankës Popullore

Neni 55

- (1) Vendi i zbrazët në Këshillin e Bankës Popullore plotësohet jo më herët se 3 muaj para skadimit të mandatit të anëtarit të Këshillit dhe jo më vonë se dy muaj pas skadimit të mandatit të një anëtarit të Këshillit.
- (2) Mandati i anëtarit të Këshillit i cili është zgjedhur në periudhën para skadimit të mandatit të anëtarit ekzistues të Këshillit fillon pas skadimit të mandatit të anëtarit ekzistues të Këshillit.
- (3) Anëtari i Këshillit të cilit i ka skaduar mandati, deri në emërimin e anëtarit të ri, i ka të njëjtat autorizime dhe i kryen të njëjtat detyra të përcaktuara me ligj.

2. Mbledhjet dhe procesverbalet e Këshillit të Bankës Popullore

Mbledhjet e Këshillit të Bankës Popullore

Neni 56

- (1) Këshilli i Bankës Popullore mban mbledhje sipas nevojës, varësisht nga aktivitetet e Bankës Popullore, por jo më pak se dhjetë herë gjatë një viti kalendarik.
- (2) Në mbledhjet e Këshillit të Bankës Popullore, ëme ftesë mund të jenë të pranishëm edhe persona tjerë të cilët nuk janë anëtarë të Këshillit të Bankës Popullore.
- (3) Për punën dhe vendimmarrjen e Këshillit të Bankës Popullore nevojitet kuorum prej së paku nga dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Bankës Popullore, duke përfshirë edhe guvernatorin, ose në mungesë të tij, viceguvernatorin i cili kryeson në pajtim me vendimin nga neni 48 paragrafi(6) i këtij ligji. Nëse kuorumi nuk është plotësuar, guvernatori mund të konvokojë mbledhje të jashtëzakonshme në të cilën mund të miratohen vendime pa kuorum, të cilat duhen të miratohen në mbledhjen e ardhshme të rregullt të Këshillit të Bankës Popullore.
- (4) Cdo anëtar i Këshillit të Bankës Popullore ka një votë dhe në rast të numrit të njëjtë të votave kryesuesi e ka votën e vendimmarrjes.
- (5) Vendimet e Këshillit të Bankës Popullore miratohen me shumicë të thjeshtë nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë ligj.
- (6) Me Rregulloren e punës të Këshillit të Bankës Popullore përcaktohet mënyra se si organizohen seancat e Këshillit të Bankës Popullore dhe mënyra e votimit të anëtarëve të Këshillit të Bankës Popullore në seanca.
- (7) Dokumentet ose procesverbalet e Këshillit të Bankës Popullore nuk konsiderohen si jovalide, kur nuk është plotësuar kuorumi nga paragrafi (3) i këtij neni për vend të zbrazët në Këshillin e Bankës Popullore.

Procesverbalet nga seancat e Këshillit të Bankës Popullore

Neni 57

- (1) Procesverbalet e seancave të Këshillit të Bankës Popullore janë informacione konfidenciale në përputhje me nenin 74 të këtij ligji.
- (2) Procesverbalet nga cdo mbledhje e Këshillit të Bankës Popullore i nënshkruan personi i cili kryeson me mbledhjen dhe sekretari i Këshillit të Bankës Popullore.
- (3) Sekretarin e Këshillit të Bankës Popullore e emëron guvernatori, nga radhet e personave me autorizime dhe përgjegjësi të posaçme në Bankën Popullore.

3. Seancat dhe procesverbalet e Këshillit Ekzekutiv

Seancat e Këshillit Ekzekutiv

Neni 57-a

- (1) Këshilli Ekzekutiv mban seanca sipas nevojës, varësisht nga aktivitetet e Bankës Popullore, por jo më pak se 12 herë gjatë një viti kalendarik.
- (2) Në seancat e Këshillit Ekzekutiv, me ftesë, mund të marrin pjesë edhe persona të tjerë që nuk janë anëtarë të Këshillit Ekzekutiv.
- (3) Për punën dhe vendimmarrjen e Këshillit Ekzekutiv nevojitet një kuorum prej së paku dy të tretave të anëtarëve të emëruar të Këshillit Ekzekutiv, duke përfshirë edhe guvernatorin i cili

kryeson ose, në mungesë të tij, viceguvernatorin që kryeson në përputhje me vendimin nga neni 48 paragrafi (6) i këtij ligji.

(4) Secili anëtar i Këshillit Ekzekutiv ka një votë dhe, në rast të numrit të njëjtë të votave, vota e kryesuesit do të jetë votë vendimtare.

(5) Vendimet e Këshillit Ekzekutiv merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm të Këshillit Ekzekutiv.

(6) Me Rregulloren e punës së Këshillit Ekzekutiv përcaktohet mënyra se si organizohen seancat e Këshillit Ekzekutiv dhe mënyra e votimit të anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv në seanca.

Procesverbalet e seancave të Këshillit Ekzekutiv

Neni 57-b

- (1) Procesverbalet e seancave të Këshillit Ekzekutiv janë informacione konfidenciale, në pajtim me nenin 74 të këtij ligji
- (2) (2) Procesverbalet e çdo seance të Këshillit Ekzekutiv i nënshkruan personi që kryeson me seancën dhe sekretari i Këshillit Ekzekutiv.
- (3) (3) Sekretarin e Këshillit Ekzekutiv e emëron guvernatori nga radhët e të punësuarve në Bankën Popullore.

4. Të punësuarit në Bankën Popullore

Marrëdhëniet e punës

Neni 58

- (1) Për guvernatorin, viceguvernatorin dhe të punësuarit e Bankës Popullore, aplikohen rregullat nga sfera e marrëdhënieve të punës, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.
- (2) Të punësuarit në Bankën Popullore janë të angazhuar profesionalisht në Bankën Popullore dhe mund të kenë angazhim tjetër punë vetëm me pëlqim të guvernatorit, nëse kjo nuk është në kundërshtim me interesat e Bankes Popullore.
- (3) Banka Popullore gjatë punësimit zbaton politikë kadrovike jodiskriminuese, në bazë etnike, fetare apo cfarëdo baze tjetër.
- (4) Personi me autorizime të vecanta i cili udhëheq me supervizionin e Bankes Popullore, në periudhe prej një viti nga mbarimi detyres nuk mund të angazhohet profesionalisht në bankë ose institucion tjetër financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 58-a fshihet.

Themelimi dhe pushimi i marrëdhënies së punës

Neni 59

Guvernatori vendos për themelimin ose pushimin e marrëdhënies së punës në Bankën Popullore dhe për çështje tjera nga marrëdhëniet e punës që nuk janë në kompetencë të Këshillit të Bankës Popullore.

IX. RAPORTET FINANCIARE DHE REVIZIONI

Politika dhe praktika të kontabilitetit

Neni 60

- (1) Banka Popullore mban evidencë të kontabilitetit në pajtim me standardet ndërkombëtare për njoftim financiar deri në shkallën e cila nuk do ta rrezikojë realizimin e qëllimeve të përcaktuara në nenin 6 paragrafet (1) dhe (2) të këtij ligji.
- (2) Viti financiar për Bankën Popullore fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor në vitin e njëjtë.

Raporte financiare

Neni 61

- (1) Banka Popullore përpilon plan financiar për vitin financiar.
- (2) Në afat prej katër muajsh pas mbarimit të vitit financiar, raportet financiare të miratuara nga Këshilli i Bankës Popullore, të nënshkruara nga guvernatori dhe të vërtetuara nga shoqëria për revizion, Banka Popullore ia dorëzon ministrit të Financave, Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (3) Raportet financiare nga paragrafi (2) i këtij neni, Banka Popullore i publikon në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe faqen e saj të internetit.
- (4) Banka Popullore në afat prej dhjetë ditësh pune pas mbarimit të çdo muaji kalendarik, përpilon dhe shpall bilanc të gjendjes me gjendjen në fund të atij muaji dhe të njëjtin ia dorëzon ministrit të Financave.

Raporte tjera

Neni 62

- (1) Banka popullore, sipas nevojës, por së paku dy herë në vit, e informon Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe publikun për politikën monetare, për realizimin e qëllimeve të veta dhe qëndrimet e veta për variablet reale në ekonomi.
- (2) Banka Popullore në afat prej katër muajsh nga mbarimi i vitit fiskal i parashtroi Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ministrit të Financave dhe shpall një ose më shumë raporte të miratuara nga Këshilli i Bankës Popullore lidhur me gjendjen në ekonomi gjatë vitit financiar i cili ka mbaruar, si dhe për perspektivat për ekonominë në vitin e ardhshëm me theks të posaçëm në qëllimet e politikave të Bankës Popullore dhe gjendjen e sistemit bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Raporti përmban pasqyrë dhe vlerësim të politikave të Bankës

Popullore të cilat janë realizuar në vitin e fundit financiar, si dhe sqarim të politikave që Banka Popullore duhet t'i zbatojë në vitin e ardhshëm financiar.

(3) Banka Popullore publikon raporte tremujore për politikën monetare në faqen e saj zyrtare dhe/ose në mënyrë tjetër të përcaktuar nga guvernatori i Bankës Popullore.

(4) Banka Popullore publikon raport për stabilitetin financiar për vitin paraprak në faqen e saj zyrtare dhe/ose në mënyrë tjetër të përcaktuar nga guvernatori i Bankës Popullore.

Revizioni i brendshëm

Neni 63

- (1) Banka Popullore krijon njësi të veçantë organizative për revizion të brendshëm.
- (2) Revizioni i brendshëm për punën e tij nga aspekti funksional, gjegjësisht nga aspekti i mbikëqyrjes së efikasitetit dhe efektivitetit të punës së tij, i përgjigjet drejtpërdrejt Këshillit të Bankës Popullore, kurse nga aspekti administrativ, respektivisht nga aspekti i punës së tij të përditshme operative është drejtpërdrejt përgjegjës para guvernatorit të Bankës Popullore.
- (3) Revizioni i brendshëm në punën e tij i zbaton Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të revizionit të brendshëm, të cilat janë pranuar si standarde për punën e revizionit të brendshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- (4) Në fushëveprimin e tij të punës, Revizioni i brendshëm i vlerëson dhe kontribuon në përmirësimin e proceseve të menaxhimit të rreziqet, të kontrolleve të brendshme dhe menaxhimit, përmes aplikimit të një qasjeje të bazuar në rreziqe.
- (5) Këshilli i Bankës Popullore miraton akt intern me të cilin në detaje i rregullohen aktivitetet e revizionit të brendshëm dhe mënyrën e raportimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të cekura në paragrafin (3) të këtij neni.
- (6) Revizioni i brendshëm e kontrollon zbatimin e aktiviteteve të cekura në nenin 61 paragrafët (2) dhe (4) të këtij ligji;
- (7) Këshilli i Bankës Popullore miraton program vjetor dhe afatmesëm për punën e Revizionit të brendshëm.
- (8) Raportet e revizionit nga kontrollet e zbatuara i dorëzohen guvernatorit të Bankës Popullore, me ç'rast konstatimet dhe rekomandimet e përfshira në to janë bazë për ndërmarrjen e masave adekuate për parregullsitë dhe dobësitë e konstatuara.
- (9) Revizioni i brendshëm përpilon raporte për punën e tij dhe, për rezultatet e punës, së paku dy herë në vit ia dorëzon Komitetit të Revizionit dhe Këshillit të Bankës Popullore. Revizioni i brendshëm përpilon raporte edhe me kërkesë të guvernatorit ose një anëtar tjetër të Këshillit të Bankës Popullore.
- (10) Revizioni i brendshëm bashkëpunon me revizorin e jashtëm i cili kryen revizion të Bankës Popullore.

Emërimi i kryerevizorit të brendshëm

Neni 64

- (1) Kryerevizorin e brendshëm të Bankës Popullore, e emëron Këshilli i Bankës Popullore me propozim të guvernatorit.
- (2) Kryerevizori i brendshëm është person i cili i plotëson kriteret për anëtar të Këshillit të Bankës Popullore nga neni 50 i këtij ligji dhe ka përvojë profesionale në sferën e kontabilitetit dhe/ose revizionit së paku prej tre vitesh.

- (3) Kryerevizori i brendshëm emërohet për periudhë prej pesë vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.
- (4) Kryerevizori i brendshëm mund të japë dorëheqje dhe për këtë e njofton guvernatorin së paku tre muaj para dhenies së dorëheqjes.
- (5) Kryerevizori i brendshëm shkarkohet në rastet nga neni 53 paragrafi (1) i këtij ligji. Vendimin për shkarkime miraton Këshilli i Bankës Popullore.

Komiteti i Revizionit

Neni 64-a

- (1) Këshilli i Bankës Popullore formon Komitetin e Revizionit si trup të përhershëm të punës.
- (2) Komisioni i Revizionit përbëhet nga tre anëtarë të cilët zgjidhen nga radhët e anëtarëve joekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore. Së paku njëri nga anëtarët e Komitetit të Revizionit duhet të ketë njohuri profesionale në fushën e kontabilitetit dhe/ose revizionit prej së paku tre vitesh.
- (3) Nëse asnjëri nga anëtarët joekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore nuk ka njohuri profesionale në fushën e kontabilitetit dhe/ose revizionit prej së paku tre vitesh, mund të angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm me përvojë dhe njohuri profesionale ose akademike në fushën e kontabilitetit dhe/ose revizionit prej së paku tre vitesh.
- (4) Bashkëpunëtori i jashtëm merr pjesë në punën e rregullt të Komitetit të Revizionit me sqarime dhe mendime profesionale për çështje nga fusha e kontabilitetit dhe revizionit, që janë në kuadër të fushëveprimit të punës së Komisionit.
- (5) Anëtarët e Komitetit të Revizionit i emëron Këshilli i Bankës Popullore.
- (6) Mandati i anëtarëve të Komitetit të Revizionit të cilët janë anëtarë joekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore duhet të harmonizohet me anëtarësimin e tyre në Këshill, ndërsa bashkëpunëtori i jashtëm emërohet për një periudhë trevjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.
- (7) Komiteti i Revizionit i ka këto kompetenca dhe detyra:
 - 1) i shqyrton politikat kontabiliste dhe raportimin financiar të Bankës Popullore;
 - 2) e monitoron procesin e përzgjedhjes dhe punën e shoqërisë së pavarur të revizionit dhe bashkëpunon me të për revizionin e raporteve të Bankës Popullore, për të gjitha çështjet kryesore që dalin nga revizioni dhe çdo dobësi në kontrollet e brendshme të Bankës Popullore të identifikuar nga shoqëria e revizionit lidhur me procesin e raportimit financiar;
 - 3) e shqyrton efikasitetin dhe efektivitetin e punës së revizionit të brendshëm;
 - 4) e shqyrton funksionimin e sistemit të kontrolleve të brendshme dhe kornizës për menaxhimin e rrezikut;
 - 5) e shqyrton përshtatshmërinë e kornizës juridike për harmonizimin e punës me rregulloret dhe efektivitetin e procesit të monitorimit të harmonizimit në nivel të Bankës Popullore;
 - 6) e informon Këshillin e Bankës Popullore në rast të lëshimeve ose parregullsive të konstatuara në punën e Bankës Popullore ose për propozime për përmirësimin e punës;
 - 7) parashtrohet raport vjetor për punën e vet në Këshillin e Bankës Popullore.
- (8) Këshilli i Bankës Popullore më hollësisht i përcakton aktivitetet e Komitetit të Revizionit që janë në fushëveprimin e punës së tij.

Revizioni

Neni 65

- (1) Shoqëri e pavarur për revizion me reputacion të mirë dhe përvojë të pranuar ndërkombëtarisht në revizion të institucioneve financiare, se paku një herë në vit kryen revizion të raporteve financiare të Bankes Popullore në pajtim me standardet ndërkombëtare për revizion.
- (2) Shpenzimet për revizion nga paragrafi (1) i këtij neni, i paguan Banka Popullore.
- (3) Shoqërinë për revizion e zgjedh Këshilli Bankës Popullore, pas procedurës së zbatuar paraprakisht në pajtim me Ligjin për furnizime publike.
- (4) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të ministrit të Financave në çdo kohë, nëse ekziston shkak i arsyeshëm, mund të kërkojë nga shoqëria për revizion nga paragrafi (1) i këtij neni, të kryejë revizion të Bankës Popullore. Raporti për revizionin e kryer i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për informim.
- (5) Shpenzimet për revizion nga paragrafi (4) i këtij neni, kompensohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (6) Shoqëria e revizionit i dorëzon raport Këshillit të Bankës Popullore për çështjet kryesore që dalin nga revizioni lidhur me raportimin financiar.
- (7) Shoqëria për revizion ka autorizim të plotë që ta shqyrtojë evidencën e përgjithshme të kontabilitetit të Bankës Popullore dhe t'i marrë të gjitha informatat për transaksionet e saj.
- (8) Shoqëria e njëjtë për revizion mund të kryejë revizion të Bankës Popullore në periudhe prej pesë vitesh të njëpasnjeshme.

Plani financiar

Neni 66

- (1) Këshilli i Bankës Popullore para fillimit të vitit financiar miraton plan financiar vjetor. Plani financiar i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për informim.
- (2) Të hyrat e përgjithshme të planifikuara nga cilido qofte burim bashkë me shpenzimet, duke përfshirë amortizimin dhe rezervimet paraqiten në planin financiar vjetor të Bankes Popullore. Në planin financiar vjetor të Bankës Popullore nuk shënohen të hyrat dhe shpenzimet e përealizuara nga ndryshimet e çmimit dhe të kursit në bilancin e Bankës Popullore.

Revizioni shtetëror

Neni 67

- (1) Pa e rrezikuar pavarësinë e Bankës Popullore dhe pavarësisht nga aktivitetet e shoqërisë të revizionit nga neni 65 paragrafi (1) i këtij ligji, Enti Shtetëror i Revizionit kryen revizion të Bankës Popullore në pjesën e investimeve në mjetet jomateriale, patundshmërive dhe pajisjes dhe shpenzimeve operative.
- (2) Procedura për miratimin e raportit përfundimtar të revizionit nga Enti Shtetëror i Revizionit kryhet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Revizion Shtetëror.
- (3) Për revizionin e kryer Enti Shtetëror i Revizionit i dorëzon Bankës Popullore dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut raport përfundimtar të revizionit.

X.

DISPOZITA TË VEÇANTA

Akte nënligjore dhe akte tjera

Neni 68

- (1) Banka Popullore miraton akte nënligjore dhe akte tjera të domosdoshme për realizimin e qëllimeve dhe detyrave që i janë ngarkuar më këtë ligj ose me ligj tjetër.
- (2) Aktet e Bankës Popullore të cilat kanë zbatim të përgjithshëm miratohen në formë të vendimit.
- (3) Për zbatimin e vendimeve që kanë zbatim të përgjithshëm, Banka Popullore mund të miratojë udhëzime.
- (4) Banka Popullore mund që në banka dhe subjekte tjera të lëshojë qarkore për rregulla të përgjithshme dhe trendet lidhur me kompetencat dhe aktivitetet e Bankës Popullore dhe ato nuk janë të obliguara juridikisht.

Shpallja e akteve nënligjore

Neni 69

- (1) Vendimet dhe udhëzimet nga neni 68 i këtij ligji të cilat kanë zbatim të përgjithshëm detyrimisht shpallen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".
- (2) Aktet juridike nga paragrafi (1) i këtij neni, Banka Popullore mund t'i shpallen faqen zyrtare të saj te internetit.
- (3) Banka Popullore mund t'i shpallë në faqen zyrtare të saj të internetit dhe aktet juridike të cilat nuk kanë zbatim të përgjithshëm.

Konflikti i interesave dhe detyra fiduciare

Neni 70

- (1) Anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore dhe të punësuarit obligohen që t'u ikin situatave të cilat mund të shkaktojnë konflikt të interesave. Konflikt i interesave ekziston kur anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore ose të punësuarit të cilët kanë interesa personale ose private që ndikojnë ose mund të ndikojnë mbi kryerjen objektive të detyrave të tyre. Me interesa private ose personale të anëtarëve të Këshillit të Bankës Popullore ose të të punësuarve nënkuptohet çfarëdo lloj dobie që potencialisht mund ta kenë vetë ata, familjet e tyre dhe familjarët e tyre deri në brezin e dytë.
- (2) Anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore dhe të punësuarit nuk guxojnë që për aktivitetet e tyre në Bankën Popullore të pranojnë çfarëdo dobie, shpërblime, kompensime ose dhurata nga cilido burim, pa marrë parasysh nëse janë në forme financiare ose jofinanciare.

(3) Shkelja e dispozitave nga paragrafi (2) i këtij neni nga ana e të punësuarve paraqet shkelje serioze të rregullave dhe njëherit paraqet bazë që guvernatori të vendosë për zbatimin e masave disiplinore, duke përfshirë pushimin nga puna.

(4) Anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore dhe të punësuarit nuk guxojnë t'i shfrytëzojnë informatat e fshehta tek të cilat kanë qasje për realizimin e transaksioneve financiare private, pa marrë parasysh nëse këtë e bëjnë drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet personave të tretë, për llogari dhe në rrezik të vet ose për llogari dhe në rrezik të personit të tretë.

(5) Para ditës së fundit nga janari çdo vit, anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore tërësisht do t'izbulojnë para Këshillit të Bankës Popullore interesat e konsiderueshme financiare që ata ose cili person tjetër me të cilin ato kanë lidhje familjare, afariste ose financiare mund drejtpërdrejt ose tërthorazi t'i posedojnë, dhe zbulimi i tillë është në pajtim me rregullat interne të miratuara nga Këshilli i Bankës Popullore.

(6) Anëtari i Këshillit të Bankës Popullore i cili para fillimit të debatit zbulon ekzistimin e konfliktit të interesave nuk merr pjesë në diskutim dhe nuk kanë të drejtë vote, mirëpo prania e tij merret parasysh gjatë formimit të kuorumit.

(7) Anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore dhe të punësuarit obligohen që interesat e Bankës Popullore dhe interesat e klientëve të Bankës Popullore të vendosin para interesit të tyre personal dhe material.

Provizione dhe kompensime

Neni 71

- (1) Banka Popullore mund të arkëtojë provizione dhe kompensime për shërbimet që i ofron.
- (2) Këshilli i Bankës Popullore i përcakton llojin dhe lartësinë e provizioneve dhe kompensimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, varësisht prej ndërlikueshmërisë dhe vëllimit të aktiviteteve.

Aktivitete të ndaluara

Neni 72

(1) Përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë ligj ose ligj tjetër, Banka Popullore nuk guxon:

- 1) të japë kredi ose dhuratë monetare ose financiare;
- 2) të kryejë veprimtari tregtare, të blejë aksione të shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe aksione të institucionit financiar, ose në mënyrë tjetër të ketë interes pronësor në shoqërinë financiare, komerciale, bujqësore, industriale ose në cilëndo shoqëri tjetër tregtare dhe
- 3) të fitojë të drejta mbi pronën e patundshme ose pronën e patundshme nëpërmjet blerjes, marrjes me qira ose në mënyrë tjetër, përveç nëse kjo është e nevojshme ose e domosdoshme për sigurimin e lokaleve të punës ose kushteve për kryerjen e detyrave të saj. (2) Me përjashtim të dispozitave nga paragrafi (1) i këtij neni, Banka Popullore mund:
 - 1) të miratojë kredi të cilat sigurohen me sigurim përkatës;
 - 2) të ketë pjesëmarrje pronësore ose në mënyrë tjetër të marrë pjesë në subjektin i cili kryen aktivitete të orientuara kah realizimi i detyrave dhe përgjegjësi të Bankës Popullore dhe
 - 3) të fitojë interes ose të drejta nga paragrafi (1) pikat 2) dhe 3) të këtij neni në bazë të arkëtimit të kërkesave, me çrast interesat ose të drejtat e fituara në këtë mënyrë doemos duhet t'i tjetërsojë në afat më të shkurtër të mundshëm.

Lirimi nga tatimimi

Neni 73

(1) Lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar qarkullimi i:

- 1) arit dhe metaleve tjera fisnike kah dhe nga Banka Popullore;
- 2) kartëmonedhave dhe monedhave që janë mjet ligjor për pagesë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe
- 3) letrës dhe bojës për shtypjen e bankënotave dhe rondeleve të pajisura për farkimin e parave të cilat janë mjet ligjor për pagesën e Republikën e Maqedonisë së Veriut, kah dhe nga Banka Popullore.

(2) Lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar importi i:

- 1) arit dhe metaleve tjera fisnike të Bankës Popullore;
 - 2) kartëmonedhave dhe monedhave që janë mjet ligjor për pagesë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe
 - 3) letrës dhe bojës për shtypjen e bankënotave dhe rondeleve të pajisura për farkimin e parave të cilat janë mjet ligjor për pagesë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- (3) Banka Popullore është liruar nga pagesa e tatimit mbi fitim.
- (4) Tatimi mbi pronën nuk paguhet për pronë të patundshme e cila është në pronësi të Bankës Popullore.

Fshehtësia

Neni 74

(1) Banka Popullore i klasifikon dhe i shënon dokumentet, informacionet dhe të dhënat që nuk janë publike me këto shkallë të fshehtësisë: "BP SEKRET PROFESIONAL", "BP KONFIDENCIALE" ose "BP PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR", në përputhje me rregullat e miratuar të Këshillit të Bankës Popullore. Dokumente, të dhëna, informacione konfidenciale në kuptim të këtij ligji, konsiderohen edhe dokumentet, të dhënat, informacionet e përkufizuara si sekrete bankare në përputhje me Ligjin e Bankave dhe zbulimi i të cilave nga personi i paautorizuar do të dëmtojte reputacionin dhe interesat e Bankës Popullore, institucioneve financiare dhe personave të tjerë juridikë të cilët janë të autorizuar nga ose puna e të cilave është nën mbikëqyrjen e Bankës Popullore.

(2) Anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore dhe të punësuarit e Bankës Popullore janë të obliguar t'i mbajnë sekret të gjitha dokumentet, informacionet dhe të dhënat konfidenciale nga paragrafi (1) i këtij neni, me të cilat janë njohur gjatë kryerjes së obligimeve dhe detyrave të tyre.

(3) Personi i cili është ose ka qenë anëtar i Këshillit të Bankës Popullore ose personi i cili është ose ka qenë i punësuar në Bankën Popullore nuk guxon të lejojë qasje, përkatësisht të mundësojë shpalosjen, publikimin, përdorimin për përfitim personal, zbulimin përmes bartjes, publikimit ose mënyrës tjetër të vënies në dispozicion të dokumenteve, informacioneve dhe të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni gjatë kryerjes së detyrave dhe obligimeve edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës ose mandatit të tyre në Bankën Popullore, përveç nëse të dhënat dhe informacionet e cekura në paragrafin (1) nuk bëhen informacione publike.

(4) Me përjashtim të paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni, një anëtar i Këshillit të Bankës Popullore ose i punësuar i Bankës Popullore mund të lejojë qasje, respektivisht të mundësojë shpalosjen, zbulimin përmes bartjes së dokumenteve, informacioneve dhe të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse:

- 1) për këtë është marrë pëlqimi nga personi të cilit i referohen të dhënat ose informacionet;
- 2) jepen në procedurë gjyqësore ose në procedurë tjetër kur Banka Popullore është palë ose palë e prekur në procedurë;

- 3) ka urdhër të gjykatës ose kërkesë nga Prokuroria Publike;
 - 4) i jepen Shoqërisë për revizion të Bankës Popullore;
 - 5) jepen në rastet dhe në mënyrën e përcaktuar me ligjin që e rregullon punën e bankave, ligjin që e rregullon ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankat dhe ligjin që e rregullon stabilitetin financiar;
 - 6) u jepen organeve rregullatorë ose të supervizionit gjatë kryerjes së detyrave të tyre për të cilat janë të autorizuar;
 - 7) ajo është e nevojshme për kryerjen e detyrave të Bankës Popullore dhe aktiviteteve lidhur me kryerjen e detyrave të saj në përputhje me këtë ligj.
- (5) Për të dhënat që do të shpalosen në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, është e nevojshme të zbatohen masa për mbrojtje nga qasja e paautorizuar.
- (6) Për të dhënat statistikore që Banka Popullore i grumbullon, përgatit dhe i publikon për kryerjen e detyrave në përputhje me nenin 7 paragrafi (1) pika 7 të këtij ligji zbatohen dispozitat për konfidencialitet statistikor dhe mbrojtjen e të dhënave të Ligjit për Statistikë Shtetërore.
- (7) Personat e jashtëm të cilët në çfarëdo mënyre zyrtarisht i kanë marrë dokumentet, informacionet dhe të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni, mund t'i përdorin vetëm për qëllimet për të cilat i kanë marrë nga Banka Popullore dhe nuk guxojnë të lejojnë qasje të paautorizuar, respektivisht për të mundësuar shpalosjen, publikimin, përdorimin për përfitim personal, zbulimin nëpërmjet bartjes, publikimit ose vënien në dispozicion të palëve të treta.
- 8) Këshilli i Bankës Popullore miraton akt me të cilin rregullohet mënyra e klasifikimit dhe shënimit të dokumenteve, informacioneve dhe të dhënave të cekura në paragrafin (1), masat për mbrojtje nga qasja e paautorizuar na paragrafi (5) i këtij neni dhe administrimi i tyre.

Përmbushja e kërkesave

Neni 75

- (1) Banka Popullore ka të drejtë parësore dhe pa kusht t'i përmbushë kërkesat që dalin nga kryerja e detyrave të tyre nga cilat do mjete monetare, letra me vlerë dhe mjete tjera që në kohën e arritjes së kërkesës i mban për llogari të debitorit përkatës në çfarëdo baze.
- (2) Nuk lejohet procedurë gjyqësore, dhe nuk lejohet kërkesë konkurruese, të cilat do ta prolongonin realizimin e të drejtave të Bankës Popullore nga paragrafi (1) i këtij neni.

Imuniteti nga konfiskimi i mjeteve

Neni 76

Kundër Bankës Popullore ose pronës së saj nuk të shqiptohet masë për konfiskimin e mjeteve, duke përfshirë ari, të drejta speciale të tërheqjes, kartëmonedha dhe monedha, kredi, depozita ose letra me vlerë, dhe çfarëdo të hyrash tjera nga kjo, para miratimit të aktgjykimit të plotfuqishëm nga gjykata kompetente.

Përgjegjësia për dëmin

Neni 77

- (1) Banka Popullore nuk përgjigjet për dëmet ndaj personave të tretë që mund të ndodhin për shkak të masave dhe aktiviteteve për ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë së institucionit financiar të veçantë ose sistemit bankar, përveç kur janë tejkaluar autorizimet e saj të përcaktuara me këtë ligj.
- (2) Për dëmet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk përgjigjen personat që janë ose kanë qenë supervizore, përveç në rast kur ato me aktgjykim të plotfuqishëm janë dënuar për vepër penale lidhur me punën.
- (3) Të punësuarit, guvernatori, viceguvernatorët dhe anëtarët joekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore, gjatë dhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, përkatësisht angazhimit në Bankën Popullore, nuk përgjigjen për dëmet ndaj personit të tretë që i kanë shkaktuar me kryerjen e detyrave të punës, nëse ato i kanë kryer në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me ligj.

Kompensimi i shpenzimeve

Neni 78

Banka Popullore i kompenson shpenzimet e procedurave gjyqësore kundër të punësuarve, guvernatorit, viceguvernatorëve dhe anëtareve joekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore lidhur me marrëdhënien e tyre të punës, përkatësisht angazhimit në Bankën Popullore, përveç në rast, nëse gjykohen në mënyrë të plotfuqishme për vepër penale lidhur me punën.

XI. MARRËDHËNIET NDËRMJET BANKËS POPULLORE DHE UNIONIT EVROPIAN

Neni 79

Banka Popullore bashkëpunon dhe shkëmben informata me Bankën Qendrore Evropiane dhe institucionet dhe trupat tjerë të Unionit Evropian.

XII. ANTARËSIMI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NË UNIONIN EVROPIAN

Dispozita të përgjithshme

Neni 80

- (1) Banka Popullore është pjesë përbërëse e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (ne tekstin e mëtejme: SEBQ).
- (2) Banka Popullore i kryen qëllimet dhe detyrat e SEBQ-së në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes për themelimin e Bashkësisë Evropiane, Statutin e SEBQ-së dhe të Bankës Qendrore Evropiane (në tekstin e mëtejme: BQE), rregullat e zbatueshme drejtpërdrejt nga Unioni Evropian dhe dispozitat e këtij ligji.

Pavarësia e Bankës Popullore

Neni 81

Pa qenë në kundërshtim me nenin 5 të këtij ligji, Banka Popullore dhe anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore nuk kërkojnë, e as pranojnë instruksione nga institucionet dhe organet e Unionit Evropian, nga cilado qoftë qeveri e vendit anëtar ose nga cili do organ tjetër. Institucionet dhe organet e Unionit Evropian dhe qeveritë e vendeve anetare nuk mund të ndikojnë në pavarësinë e Bankës Popullore, në miratimin dhe implementimin e vendimeve të Bankës Popullore dhe të organeve të saj, e as nuk mund të miratojnë, revokojnë, prolongojnë, anulojnë ose në çfarëdo mënyre të ndikojnë në vendimet e Bankës Popullore dhe të organeve të saj.

Qëllimet e Bankës Popullore si pjesë e SEBQ-së

Neni 82

Banka Popullore i përkrah politikat e përgjithshme ekonomike të Unionit Evropian me qëllim të përmbushjes së qëllimeve nga neni 2 i Marrëveshjes për themelimin e Bashkësisë Evropiane, pa qenë në kundërshtim me qëllimet nga neni 6 i këtij ligji. Banka Popullore punon në pajtim me parimin e ekonomisë së hapur të tregut me konkurrencë të lirë dhe në pajtim me parimet nga neni 4 i Marrëveshjes për themelimin e Bashkësisë Evropiane.

Regjistrimi i kapitalit

Neni 83

Banka Popullore regjistron dhe paguan kapital në BQE në pajtim me nenet 28 dhe 29 nga Statuti i SEBQ-së edhe i BQE-së.

Kompetencat dhe autorizimet për implementimin e politikës së kursit devizor

Neni 84

- (1) Gjatë miratimit të masave lidhur me kursin devizor të valutës vendore, Banka Popullore i merr parasysh interesat e përbashkëta të vendeve anëtare të Unionit Evropian.
- (2) Këshilli i Unionit Evropian lidhur me politikën e kursit devizor ka të gjitha autorizimet nga neni 111 nga Marrëveshja për themelimin të Bashkësisë Evropiane.

Roli këshillëdhënës i BQE-së

Neni 85

- (1) Propozim-ligjet dhe rregullat të cilat kanë të bëjnë me sfera në kompetencë të BQE-së dorëzohen për mendim të BQE-ja.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut i dorëzon propozim-ligjet dhe rregullat nga paragrafi (1) i këtij neni të Banka Popullore për informim.

(3) Për sferat jashtëkompetencës së BQE-se, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut konsultohet me Bankën Popullore gjatë përpilimit të rregullave që kanë të bëjnë me çështjet lidhur me qëllimet, detyrat dhe kompetencat e Bankës Popullore.

Mbrojtja e bankënotave dhe monedhave nga falsifikimi

Neni 86

Me qëllim të realizimit efikas të aktiviteteve lidhur me mbrojtje në bankë notave dhe monedhave nga falsifikimi, Banka Popullore përcakton masa në pajtim me rregullat e Unionit Evropian.

Ndalimi për kreditim

Neni 87

(1) Pa qenë në kundërshtim me nenin 44 të këtij ligji, Banka Popullore, në pajtim me nenin 101 nga Marreveshja për themelim të Bashkësisë Evropiane nuk mund t'u miratojë linja kreditore institucioneve dhe trupave të Unionit Evropian, autoriteteve qendrore rajonale dhe lokale, organeve tjera me autorizime publike dhe ndërmarrjeve publike që janë të kontrolluaranga vendet anëtare.

(2) Banka Popullore nuk mund drejtpërdrejtë të fitojë letra me vlere debitore të lëshuara nga personat dhe organet e theksuara në paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Me përjashtim, ndalimi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk ka të bëjë me bankat në pronësi shtetërore, kur ato fitojnë trajtim të njëjte si institucionet kreditore private.

(4) Me përjashtim, ndalimi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk ka të bëjë me huat njëditore të miratuara për qeveritë e vendeve anëtare. Huat doemos duhet të kthehen deri në fund të ditës dhe pagesa nuk mund të prolongohet për ditën e ardhshme.

E drejta e ankesës gjatë shkarkimit nga funksioni

Neni 88

Kundër vendimit për shkarkim nga funksioni, guvernatori i Bankës Popullore ka të drejtë ankese para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Të gjithë anëtarët tjerë të Këshillit të Bankës Popullore kundër vendimit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkarkim nga funksioni, kanë të drejtë të ngrejnjë kontest administrativ para gjykatës kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Anëtarësimi në trupat e BQE-së

Neni 89

Guvernatori i Bankës Popullore është anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të BQE-së.

Fshehtësia e të dhënave

Neni 90

- (1) Dorëzimi i të dhënave të BQE-ja si obligim i përcaktuar në Statutin e SEBQ-së dhe të BQEse nuk konsiderohet si publikim i të dhënave të fshehta.
- (2) Të dhënat e fshehta të Bankës Popullore nuk u publikohen paleve të treta, as në rast kur janë plotësuar kushtet nga neni 74 i këtij ligji, nëse publikimi i tillë është në kundërshtim me obligimet dhe detyrat e Bankës Popullore të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes për themelimin e Bashkësisë Evropiane dhe Statutin e SEBQ-së dhe të BQE-se.

Grumbullimi i të dhënave statistikore

Neni 91

Me qëllim të kryerjes së detyrave dhe arritjes së qëllimeve të BQE-se, Banka Popullore merr pjesë në grumbullimin, përpunimin dhe distribuimin e të dhënave statistikore në pajtim me nenin 5 të Statutit të SEBQ-se dhe të BQE-se dhe me këtë ligj.

Ndalimi për qasje të privilegjuar

Neni 92

Në pajtim me nenin 102 të Marrëveshjes për themelimin të Bashkësisë Evropiane, ndalimi për qasje të privilegjuar të institucionet financiare nga neni 45 i këtij ligji, ka të bëjë edhe me institucionet dhe trupat e Unionit Evropian, pushtetet qendrore, rajonale, lokale, organet tjera me autorizime publike ose ndërmarrjet publike të vendeve anëtare të Unionit Evropian.

XIII. APLIKIMI I EUROS SI NJËSI MONETARE NE REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Detyrat e Bankës Popullore si pjesë e SEBQ-së

Neni 93

- Në pajtim me Marrëveshjen për themelimin e Bashkësisë Evropiane dhe Statutin e SEBQ-së dhe të BQE-së, Banka Popullore i kryen detyrat në vijim: 1) merr pjesë në zbatimin e politikës monetare të Unionit Evropian;
- 2) i kryen operacionet devizore në pajtim me nenin 111 nga Marrëveshja për themelimin e Bashkësisë Evropiane;

- 3) e ruan dhe menaxhon me pjesën e rezervave devizore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila nuk është transferuar në BQE dhe
- 4) siguron funksionim të papenguar të sistemeve të pagesës.

Detyrat e Bankës Popullore

Neni 94

Duke mos i vënë në pikëpyetje detyrat nga neni 93 i këtij ligji dhe pavaresinë e saj, Banka Popullore i kryen edhe detyrat ne vijim:

- 1) rregullon, lëshon leje dhe kryen supervizion të institucioneve kreditore dhe institucioneve tjera financiare në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj ose me ligj tjetër;
- 2) kryen mbikëqyrje mbi zbatimin e rregullave me të cilat rregullohet puna devizore, puna e këmbimoreve, kryerja e shërbimeve transfert i shpejtë i parave, sistemet për parandalimin e larjes së parave dhe mbrojtja e konsumatorëve, në pajtim me këtë ligj ose ligj tjetër;
- 3) hap llogari dhe pranon mjete të institucioneve kreditore, kryen qarkullim pagesor për ato llogari dhe u miraton kredi institucioneve kreditore; 4) grumbullon dhe përpunon të dhëna statistikore;
- 5) vendos, zhvillon, regjistron dhe kryen mbikëqyrje mbi sigurinë, stabilitetin dhe efikasitetin e sistemeve për pagesë, barazim dhe kliring;
- 6) kryen punë të agentit fiskal për Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj për Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- 7) miraton rregulla nënligjore për punët në kompetencë të vet dhe
- 8) kryen punë tjera të përcaktuara me rregulla tjera, nëse nuk janë në kundërshtim me detyrat e përcaktuara në nenin 3 të Statutit të SEBQ-se edhe të BQE-së.

Pjesëmarrja në institucionet monetare ndërkombëtare

Neni 95

Banka Popullore mund të marrë pjesë në punën e institucioneve monetare ndërkombëtare vetëm me pëlqim të BQE-së.

Pjesëmarrja në zbatimin e politikës monetare

Neni 96

- (1) Banka Popullore si pjesë përberëse e SEBQ-se merr pjesë në zbatimin e politikës monetare dhe kryen kontroll monetar.
- (2) Në zbatimin e politikës monetare, Banka Popullore obligohet që të veprojë në pajtim me aktet juridike të BQE-se dhe rregullat e trupave tjera kompetente të Unionit Evropian.
- (3) Për sigurimin e zbatimit të papenguar të akteve juridike nga paragrafi (1) i këtij neni, Banka Popullore me mendim parapraktë BQE-se mund të miratojë akte për zbatim.
- (4) Aktet nga paragrafi (2) i këtij neni doemos duhet plotësisht të jenë në pajtim me aktet juridike të BQE-se.

Masat për parandalimin e likuiditetit jashtëmase të tregut

Neni 97

Me qëllim të parandalimit të rritjes së pakontrolluar të likuiditetit të tregut i cili mund të ndodhë në ditën e miratimit të euros si njësi monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e për shkak të obligimeve të bankave dhe kursimoreve që ta harmonizojnë shumën e rezervave të detyrueshme nga Banka Popullore me shumën e rezervave të detyrueshme të përcaktuara nga BQE-ja, Banka Popullore mund në aktet nënligjore të përcaktojë masa.

Operacionet në treg të hapur dhe punët kreditore

Neni 98

Për realizimin e qëllimeve për kryerjen e detyrave të SEBQ-së, e në pajtim me nenin 18 të Statutit të BQE-se, Banka Popullore mund:

- 1) të marrë pjesë në tregjet financiare nëpërmjet blerjes dhe shitjes së bazës definitive (momentale dhe me afat) ose me marrëveshjet repo ose me dhënien dhe marrjen hua ët kërkesave, instrumenteve të tregut (që janë në valutën e bashkësisë ose të ndonjë valutë tjetër) dhe metaleve fisnike dhe
- 2) të kryejë punë kreditore me bankat dhe pjesëmarrësit tjerë në treg, nëpërmjet dhënies së kredive në bazë të sigurimit përkatës.

Rezerva e detyrueshme minimale

Neni 99

- (1) BQE-ja mund të kërkojë nga institucionet kreditore të mbajnë rezervë të detyrueshme minimale në llogari të BQE-ja dhe të Banka Popullore për realizimin e qëllimeve të politikës monetare dhe në pajtim me nenin 19 të Statutit të SEBQ-se edhe të BQE-se.
- (2) Këshilli i Unionit Evropian përcakton kushtet, bazën dhe përqindjen e llogaritjes së rezervës së detyrueshme, si dhe mënyrën dhe afatet për ndarjen dhe mbajtjen e rezervës së detyrueshme.
- (3) Nëse institucioni kreditor nuk i përmbahet kërkesës së BQE-se nga paragrafi (1) i këtij neni, BQE-ja mund t'i caktojë bankës kamatë ndëshkuese dhe/ose t'i shqiptojë sanksion tjetër me efekt të ngjashëm.

Instrumente tjera të kontrollit monetar

Neni 100

Banka Popullore aplikon edhe instrumente tjera në kontrollin monetar të përcaktuara nga Këshilli Drejtues i BQE-se në pajtim me nenin 20 të Statutit të SEBQ-së dhe të BQE-së.

Punët devizore

Neni 101

(1) Në pajtim me dispozitat nga Marrëveshja për themelimin e Bashkësisë Evropiane dhe nenin 23 të Statutit të SEBQ-se dhe të BQE-se, Banka Popullore mund:

- 1) të vendosë marrëdhënie me bankat qendrore dhe me institucionet financiare me vende të treta dhe, nëse është e përshtatshme, me organizata ndërkombetare;
- 2) të blejë dhe të shesë (momentalisht dhe me afat)dhe në mënyrë tjere t'i fitojë të gjitha llojet e pronës në valutë të huaj dhe metale fisnike;
- 3) ta mbajë dhe menaxhojë me pronën nga pika 2 e këtij paragrafi dhe
- 4) t'i kryejë të gjitha format tjera të transaksioneve bankare në raportet me vendet e treta dhe me organizatat ndërkombetare, duke i përfshirë edhe punët e dhënies dhe marrjes së huas.

(2) Prona në valutë të huaj nga paragrafi (1) pika 2) e këtij neni i pëfshin edhe letrat me vlerë dhe gjithë pronën tjetër në cilëndo valutë të huaj ose njësi llogaritëse pavarësisht nga forma në të cilën mbahet.

Rezervat devizore

Neni 102

Prona nga neni 101 paragrafi (1) pika 2 e këtij ligji, i përbën rezervat devizore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Bartja e pjesës nga rezervat devizore të BQE-së

Neni 103

(1) Banka Popullore obligohet që të bartë pjesë nga rezervat devizore nga neni 102 i këtij ligji në BQE, në pajtim me nenin 30 të Statutit të SEBQ-se dhe të BQE-se.

(2) Banka Popullore, nëse këtë ia ngarkon BQE-ja, në emër dhe për llogari të BQE-së, mund të menaxhojë me pjesën e bartur nga rezervat devizore nga paragrafi (1) i këtij neni, në pajtim me drejtimitet e BQE-së.

Rezervat devizore të pabartshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Neni 104

(1) Pjesa nga rezervat devizore nga neni 102 i këtij ligji, që nuk i është bartur BQE-së, në pajtim me nenin 103 të këtij ligji i përbën rezervat devizore të Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilat i ruan dhe me to menaxhon Banka Popullore.

(2) Rezervat devizore të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga paragrafi (1) i këtij neni janë pjesë e bilancit të Bankës Popullore.

(3) Banka Popullore menaxhon me rezervat devizore nga paragrafi (1) i këtij neni në pajtim me politikën personale, duke i respektuar parimet e sigurisë, likuiditetit dhe profitit gjatë depozitimit.

(4) Për transaksionet me rezerva devizore të pabartshme dhe transaksionet me mjetet nga llogaritë devizore rrjedhëse të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që e tejkalojnë shumën e përcaktuar me drejtimitet e Keshillit Drejtues në pajtim me nenin 31 të Statutit të SEBQ-se dhe të BQE-se, nevojitet pelqim nga BQE-ja.

(5) Me përjashtim të paragrafit (4) të këtij neni, pëlqimi nga BQE-ja nuk nevojitet në rast të kryerjes së transaksionit që del nga plotësimi i obligimeve ndaj organizatave ndërkombëtare nga neni 101 i këtij ligji.

Emetimi i kartemonedhave dhe i monedhave

Neni 105

(1) Banka popullore mund të emetojë kartëmonedha që janë në euro në kuadër të limiteve të vendosura nga BQE-ja, e në pajtim me dispozitat e Statutit të SEBQ-së dhe BQE-së dhe dispozitat e Marrëveshjes për themelimin e Bashkësisë Evropiane.

(2) Banka popullore mund të emetojë monedha që janë në euro me leje të BQE-së për sasinë e emetimit. Banka popullore do t'i zbatojë rregullat për denominacion dhe specifikim teknik të monedhave në pajtim me rregullat relevante të Unionit Evropian.

Përcaktimi i pamjes së monedhave

Neni 106

Banka popullore merr pjesë në përcaktimin e pamjes së monedhave që i emeton, me ç'rast i zbaton rregullat relevante të Unionit Evropian.

Sisteme të pagesës në kuadër të Bashkimit Evropian

Neni 107

(1) Banka Popullore siguron kushte për funksionimin e papenguar dhe efikas të sisteme të pagesave në kuadër të Unionit Evropian dhe jashtë tij, duke i zbatuar me këtë rast edhe rregullat e BQE-se dhe rregullat e trupave tjere kompetente të Unionit Evropian.

(2) Për sigurimin e zbatimit të papenguar të rregullave nga paragrafi (1) i këtij neni, Banka Popullore në pajtim me BQE-në mund të miratojë akte për zbatim.

(3) Aktet nga paragrafi (2) i këtij neni doemos duhet që në tërësi të harmonizohen me rregullat e BQE-së dhe rregullat e trupave tjerë kompetente të Unionit Evropian.

Detyrat dhe autorizimet e Këshillit të Bankës Popullore

Neni 108

Këshilli i Bankës popullore është kompetent për:

- 1) miratimin e planit financiar të Bankës Popullore;
- 2) miratimin e raporteve nga neni 61 i këtij ligji;

- 3) miratimi i rregullave nënligjore me të cilat përcaktohet mënyra e punës së sistemeve të pagesave, nëse është i autorizuar për miratimin e tyre me këtë ligj dhe me Statutin e SEBQ-se dhe të BQE-se;
- 4) miratimin e rregullave nënligjore me të cilat rregullohet emëtimi i monedhave, nëse për miratimin e tyre është i autorizuar me këtë ligj dhe Statutin e SEBQ-se dhe BQE-se, si dhe me rregullat relevante të Unionit Evropian;
- 5) përcaktimin e strategjisë dhe politikës për menaxhim me pjesën e pabartshme nga rezervat devizore;
- 6) vendimmarrje për antarësim të Bankes Popullore në institucionet dhe organizatat ndërkombetare dhe
- 7) vendimmarrje për antarësim të Bankës Popullore në institucionet monetare ndërkombetare për të cilat nevojitet pëlqimi i BQE-së.

Antarësimi në trupat e BQE-se

Neni 109

Guvernatori i Bankës Popullore është anëtar i Këshillit Drejtues të BQE-së.

Kapitali i Bankës Popullore

Neni 110

Në ditën e aplikimit të euros si njësi monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut kapitali i Bankes Popullore në shumë prej 1 289 789 232 denarë shndërrohet në euro sipas shkallës së përcaktuar të konverzionit (denare/euro).

Raportet Financiare të Bankës Popullore

Neni 111

- (1) Banka Popullore përpilon raporte financiare në pajtim me rregullat e kontabilitetit dhe udhëzimet e BQE-se.
- (2) Në raportin financiar vjetor të Bankës Popullore paraqitet edhe pjesa e të hyrave monetare të SEBQ-se dhe BQE-se, e cila është e përcaktuar nga BQE-ja në pajtim me Statutin e SEBQ-së dhe të BQE-se, ndërsa krijohet me zbatimin e politikës së përbashkët monetare.

Zgjedhja e revizorit

Neni 112

Vendimi për zgjedhjen e revizorit të jashtëm të pavarur të raporteve financiare të Bankës Popullore miratohet në pajtim me Statutin e SEBQ-së dhe të BQE-së.

Rregullat nënligjore

Neni 113

Për zbatimin e drejtimeve të BQE-së që kanë të bëjnë me sferat në kompetencë të BQE-se, Banka Popullore me pëlqim të BQE-se, miraton rregulla nenligjore.

Sanksionet e BQE-së

Neni 114

- (1) Banka Popullore e zbaton sistemin e sanksioneve të BQE-se në sferat të cilat BQE-ja i rregullon me rregullat e saj, në pajtim me Marrëveshjen për themelimin e Bashkësisë Evropiane.
- (2) Banka Popullore merr pjesë në procedurën për shqiptimin e sanksioneve nga ana e BQE-së, në pajtim me rregullat e BQE-se dhe rregullat tjera të trupave të Unionit Evropian.

XIV. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE

Organi kundërvajtes

Neni 115

Për kundërvajtjet që parashihen me këtë ligj procedurë kundërvajtëse dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

Puna e Komisionit për Kundërvajtje

Neni 116 fshihet

Neni 117

(1) Gjobë në shumë prej 8.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet bankës, filialit të bankës së huaj dhe kursimores, nëse nuk është në pajtim me obligimin për rezerve të detyrueshme, ose nëse nuk është në pajtim me kushtet, bazën dhe përqindjen e llogaritjes së rezervës së detyrueshme, si dhe mënyrën dhe afatet për ndarjen dhe mbajtjen e rezervës së detyrueshme (neni 20).

(2) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë në denar do t'i shqiptohet përkundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni personit përgjegjës në bankë, filialë ose në bankë të huaj dhe kursimore.

Neni 117-a

(1) Gjobë në shumë prej 800 deri 1.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje mikro tregtarit, gjobë në shumë prej 1.600 euro deri 2.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të vogël, gjobë në shumë prej 5.000 deri 6.000 ne kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të mesëm dhe gjobe në shumë prej 8.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të madh të cilët nuk i përmbahen ose veprojnë në kundërshtim me kushtet dhe mënyrën e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha (neni 25).

(2) Gjobë në shumë prej 100 deri 500 euro në kundërvlerë do t'i shqiptohet për kundërvajtje të paragrafit (1) të këtij neni edhe përgjegjësit në personin juridik.

Neni 117-b

(1) Gjobë në shumë prej 800 deri 1.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje mikro tregtarit, Gjobë në shumë prej 1.600 euro deri 2.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të vogël, Gjobë në shumë prej 5.000 deri 6.000 në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të mesëm dhe Gjobë në shumë prej 8.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të madh të cilët nuk i përmbahen ose veprojnë në kundërshtim me kushtet dhe mënyrën e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha (neni 26).

(2) Gjobë në shumë prej 100 deri 500 euro në kundërvlerë do t'i shqiptohet për kundërvajtje të paragrafit (1) të këtij neni edhe përgjegjësit në personin juridik.

Neni 118

(1) Gjobë në shumë prej 800 deri 1.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohen për kundërvajtje mikro tregtarit, gjobë në shumë prej 1.600 deri 2.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohen për kundërvajtje tregtarët të vogël, gjobe në shumë prej 5.000 deri 6.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohen për kundërvajtje tregtarit të mesëm dhe gjobë në shumë prej 8.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të madh të cilët pa leje paraprake me shkrim nga Banka Popullore do të kryejnë reproduksion të kartëmonedhave dhe monedhave të cilat janë mjet ligjor për pagesë në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose do të krijojnë lëndë të cilat sipas dizajnit të vet imitojnë kartëmonedha ose monedha të tilla (neni 30).

(2) Gjobë në shumë prej 100 deri 500 euro në kundërvlerë në denar do të shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni në personin përgjegjës në personin juridik.

Neni 119

Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik përkatësisht tregtari individual që pa leje paraprake me shkrim nga Banka Popullore do të kryejë reproduksion të kartëmonedhave dhe monedhave që janë mjet ligjor për pagesë në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose do të krijojnë sende që sipas dizajnit të tyre imitojnë kartëmonedha të tilla dhe monedha (neni 30).

Neni 120

(1) Gjobë në shumë prej 4.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje të kryer bankes, filialit të bankes së huaj dhe kursimore e cila është e detyruar të dorëzojë të dhëna të statistikës dhe informata, nëse:

- 1) nuk i dorëzon ose nuk i dorëzon në kohë në Bankën Popullore të dhënat e statistikës dhe informatat në pajtim me nenin 36 të këtij ligji dhe
- 2) nuk dorëzon ose nuk i dorëzon në kohë të dhënat dhe informatat në Bankën Popullore informatat për udhëheqjen e Regjistrimit kreditor (neni 39).

(2) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni përgjegjesit në bankë, filial të bankës së huaj dhe kursimore.

(3) Gjobë në shumë prej 800 deri 1.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje mikro tregtarit, gjobë në shumë prej 1.200 euro deri 1.500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të vogël, gjobë në shumë prej 2.500 deri 3.000 në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të mesëm dhe gjobë në shumë prej 4.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të madh për kundërvajtje të paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 100 deri 500 euro në kundërvlerë do t'i shqiptohet për kundërvajtje të paragrafit (3) të këtij neni edhe për përgjegjësin në personin juridik.

(5) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë do t'i shqiptohet tregtarit individual për kundërvajtje të paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 121

Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik i cili nuk i dorëzon ose i dorëzon jo në kohë të Bankës Popullore të dhënat statistikore dhe informatat në pajtim me nenin 36 të këtij ligji.

Neni 122

Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje guvernatorit, viceguvernatorit dhe anëtarëve joekzekutiv të Këshillit të Bankës Popullore, nëse:

- gjatë mandatit kryejnë profesione tjera (neni 50 paragrafi (3));
- nuk japin deklaratë me shkrim për çështje të caktuar në rast kur objektiviteti i tyre është i cënuar për shkak të konfliktit të interesave në aspekt të asaj çështjeje, dhe nuk përjashtohen nga miratimi i vendimit (neni 70) dhe
- zbulojnë informata të klasifikuara me shkallë përkatëse të fshehtësisë, pa marrë parasysh mënyrën me të cilën e kanë kuptuar gjatë kryerjes së funksionit të tyre (neni 74).

Neni 123

(1) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje të punësuarit në Bankën Popullore ose personit tjetër fizik nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes,

publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP SEKRET PROFESIONAL", pa marrë parasysh se si ka arritur gjatë kryerjes së detyrave të tij (neni 74).

(2) Gjobë në shumë prej 800 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denare do t'i shqiptohet për kundërvajtje mikro-tregtarit, gjobë në shumë prej 1.200 deri 1.500 euro në kundërvlerë me denare do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të vogël, gjobë në shumë prej 2.500 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denare do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të mesëm dhe gjobë në shumë prej 4.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë me denare do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të madh nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes, publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP SEKRET PROFESIONAL", pa marrë parasysh se si ka arritur në kuadër të punës së tij (neni 74).

(3) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denare do t'i shqiptohet për kundërvajtje guvernatorit, viceguvernatorit dhe anëtarit joekzekutiv të Këshillit të Bankës Popullore nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes, publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP SEKRET PROFESIONAL", pa marrë parasysh se si ka arritur gjatë kryerjes së detyrave të tij (neni 74).

(4) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denare do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes, publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP SEKRET PROFESIONAL", pa marrë parasysh se si ka arritur gjatë kryerjes së detyrave të tij (neni 74).

(5) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denare do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit-individual nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes, publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP SEKRET PROFESIONAL", pa marrë parasysh se si ka arritur në kuadër të punës së tij (neni 74).

Neni 123-a

(1) Gjobë në shumë prej 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje të punësuarit në Bankën Popullore ose personit tjetër fizik nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes, publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP KONFIDENCIALE", pa marrë parasysh se si ka arritur gjatë kryerjes së detyrave të tij (neni 74).

(2) Gjobë në shumë prej 800 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje mikro-tregtarit, gjobë në shumë prej 1.200 deri 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të vogël, gjobë në shumë prej 2.000 deri 2.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të mesëm dhe gjobë në shumë prej 3.000 deri 4.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të madh nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes, publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP KONFIDENCIALE", pa marrë parasysh se si ka arritur në kuadër të punës së tij (neni 74).

(3) Gjobë në shumë prej 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje guvernatorit, viceguvernatorit dhe anëtarit joekzekutiv të Këshillit të Bankës Popullore nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes, publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP KONFIDENCIALE", pa marrë parasysh se si ka arritur gjatë kryerjes së detyrave të tij (neni 74)

(4) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes, publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP KONFIDENCIALE", pa marrë parasysh se si ka arritur gjatë kryerjes së detyrave të tij (neni 74).

(5) Gjobë në shumë prej 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit-individual nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes, publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP KONFIDENCIALE", pa marrë parasysh se si ka arritur në kuadër të punës së tij (neni 74).

Neni 123-b

(1) Gjobë në shumë prej 150 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje të punësuarit në Bankën Popullore ose personit tjetër fizik nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes, publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR", pa marrë parasysh se si ka arritur gjatë kryerjes së detyrave të tij (neni 74).

(2) Gjobë në shumë prej 300 deri 5.00 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje mikro-tregtarit gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të vogël, gjobë në shumë prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të mesëm dhe gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit të madh nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes, publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR", pa marrë parasysh se si ka arritur në kuadër të punës së tij (neni 74).

(3) Gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje guvernatorit, viceguvernatorit dhe anëtarit joekzekutiv të Këshillit të Bankës Popullore nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes, publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR", pa marrë parasysh se si ka arritur gjatë kryerjes së detyrave të tij (neni 74).

(4) Gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes, publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR", pa marrë parasysh se si ka arritur gjatë kryerjes së detyrave të tij (neni 74).

(5) Gjobë në shumë prej 150 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit-individual nëse mundëson qasje të paautorizuar, gjegjësisht shpalos, publikon, përdor për përfitim personal, zbulon përmes bartjes, publikimit ose vënies në dispozicion të palëve të treta dokumente, informacione ose të dhëna të krijuara nga Banka Popullore të klasifikuara si "BP PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR", pa marrë parasysh se si ka arritur në kuadër të punës së tij (neni 74).

Neni 123-v

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik bëhet në përputhje me Ligjin për Kundërvajtje.

Neni 124 fshihet

XV. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 125

(1) Guvernatori dhe viceguvernatorët e Këshillit të Bankës Popullore të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në ditën e hyrjesne fuqi të këtij ligji, mbeten në detyrë deri në përfundimin e mandatit të tyre.

(2) Anëtarët e jashtëm të Këshillit të Bankës Popullore të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji mbeten anëtarëjoekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore dhe mbesin në detyrë deri në skadimin e mandatit të tyre.

(3) Guvernatori, viceguvernatorët dhe anëtarët joekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore obligohen që në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të harmonizohen me dispozitat nga neni 50 i këtij ligji.

(4) Viceguvernatori i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, i cili nuk është anëtar i Këshillit të Bankës Popullore, bëhet anëtar i Këshillit të Bankës Popullore në ditën e përfundimit të mandatit të cilit do anëtari joekzekutiv të Këshillit të Bankës Popullore.

Neni 126

(1) Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në hyrjen në fuqi të rregullës nga paragrafi (1) i këtij neni do të zbatohen rregullat ekzistuese.

Neni 127

(1) Dispozitat nga Kapitulli XII. Anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Unionin Evropian me nenet 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 93 dhe 94 të këtij ligji do të zbatohen nga dita e aderimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Unionin Evropian. (2) Dispozitat nga Kapitulli XIII. Aplikimi i euros si njësi monetare në Republikën e

Maqedonisë së Veriut me nenet 95, 96, 97, 98, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 111, 112, 113, 114 dhe 115 të këtij ligji do të zbatohen nga dita e aplikimit të euros si njësi monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 128

(1) Në ditën e aderimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Unionin Evropian, shfuqizohen dispozitat nga nenet 6 paragrafi (2), 44 dhe dispozita nga neni 79 i këtij ligji.

(2) Me ditën e aderimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Unionin Evropian, për kundërvajtjet nga neni 120 i këtij ligji, procedure kundërvajtëse do të udhëheqë gjykata kompetente.

Neni 129

Në ditën e aplikimit të euros si njësi monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut shfuqizohen dispozitat nga nenet 7, 12 paragrafi (1), 14 paragrafi(1), 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 40 paragrafi (1), 47 pikat 1, 2, 15, 16, 18 dhe 20, 48 paragrafi (1) pikat 2, 4 dhe 6, 60 paragrafi(1), 65, 73 paragrafi (1) pikat 2 dhe 3 dhe paragrafi(2) pikat 2 dhe 3, 84, 115 paragrafet (1), (3), (4), (5), (6) dhe (7), 116, 117, 118 dhe 119 të këtij ligji.

Neni 130

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 3/2002, 51/2003, 85/2003, 40/2004, 61/2005 dhe 129/2006).

Neni 131

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

DISPOZITA TE VLEFSHME KALIMTARE NGA NOVELAT E LIGJIT

I. "Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonisë", nr. 43/2014

Neni 4

Viceguvernatorët dhe anëtarët joekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore të emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të nenit 1 të këtij ligji vazhdojnë ta kryejnë funksionin deri në kalimin e mandatit për të cilin janë emëruar.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", përveç dispozitave nga neni 3 të këtij ligji që do të fillojnë të zbatohen nga dita e fillimit të zbatimit të Ligjit për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14).

II. "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 83/2018

Neni 2

Dispozita nga neni 50-a paragrafi (2) pika 1) të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 158 /10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16) dhe dispozitat e nenit 1 të këtij ligji, me të cilën neni 50-a paragrafi (2) pika 1) plotësohet me aline të re 6, nuk do të zbatohet nga dita hyrja në fuqi e këtij ligji deri me 1 shtator 2018.

Neni 3

Viceguvernatori dhe anëtari joekzekutiv i Këshillit të Bankës Popullore të cilët janë emëruar në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri me 1 shtator 2018 janë të detyruar ta plotësojnë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit të tij.

Viceguvernatori dhe anëtarët joekzekutiv të Këshillit të Bankës Popullore i cili nuk do të plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni i pushon mandati.

III. "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 110/2021

Neni 21

Kundërvajtjet e filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të kryhen sipas Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18).

IV. "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 74/2024

Neni 53

- (1) Guvernatori dhe viceguvernatorët e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, si anëtarë ekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore, qëndrojnë në detyrë deri në përfundimin e mandatit për të cilin kanë qenë të emëruar.
- (2) Anëtarët joekzekutivë të Këshillit të Bankës Popullore të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të qëndrojnë në detyrë deri në skadimin e mandatit për të cilin janë emëruar.

Neni 54

Këshilli Ekzekutiv fillon me punë jo më vonë se 30 ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 55

Komiteti për Revizion do të formohet nga Këshilli i Bankës Popullore dhe do të fillojë me punë më së voni në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 56

Aktet nënligjore të parashikuara me këtë ligj do të miratohen brenda gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 57

(1) Dispozitat e Ligjit për Banka do të harmonizohen me dispozitat e nenit 29 të këtij ligji, me të cilin shtohet nen i ri 48-a paragrafi (1) pika 3) dhe 5) brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit nga paragrafi (1) i këtij neni, do të zbatohen dispozitat e nenit 2 pikat 1, 24, 25 dhe 30 dhe nenet 3, 4, 5, 11, 13, 16, 17. do të aplikohen 18, 20, 22,36, 46, 47, 48, 50, 51, 56, 56-d,57, 58, 59, 60, 64, 65, 65- e, 83, 86, 89, 94,103,105, 107, 108, 109, 115, 118, 123, 125, 126, 131, 132, 133, 134,135, 136,137, 138, 118, 139,14 150,151, 152,153, 154, 157, 158,160, 169, 170, 172, 174, 175, 179, 186, 187, 187-a, 187-b, 187-v, 187-g, 188-a dhe 189-a të Ligjit për Banka ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 67 /07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16, 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 101/19 dhe 122/21).

Neni 58

Dispozitat e nenit 3 të këtij ligji, me të cilin në nenin 7 shtohet pikë e re 10- b), nenit 21 të këtij ligji, me të cilin shtohet neni 38-a, dhe nenit 29 të këtij ligji, me të cilin shtohet një neni i ri 48-a paragrafi (1) pika 4) do të fillojnë të zbatohen në ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mbi Bankat (*) ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 209/23).

Neni 59

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut"

V. „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 16/25

(1) Shuma e rezervës speciale e përcaktuar në pajtim me nenin 13, paragrafi (4) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 158/10, 64/12, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18” dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 110/21 dhe 74/24), do të transferohen në llogarinë e rezervës së përgjithshme brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Në afatin e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, Banka Popullore nuk mund t'i shfrytëzojë rezervat speciale.